

COLLANA DIRETTA DA FRANCESCO ALTIMARI

ALBANICA

3

RACCONTI POPOLARI

di Spezzano Albanese

Raccolti, trascritti e tradotti in italiano
da *P. VINCENZO MALAJ*

Volume edito con il contributo di



Commissione Europea
DG XXII - Progetto BETLA



Università della Calabria
Cattedra di Lingua e Letteratura albanese

Redazione e revisione dei testi italiani
a cura di *Vincenzo Belmonte*
Redazione e revisione dei testi albanesi
a cura di *Francesco Marchianò* e *Filomena Raimondo*

Le foto riportate nel libro, che si riferiscono a costumi tradizionali, chiese, paesaggi, momenti di vita della comunità spezzanese del XX secolo, sono state gentilmente concesse dal “Bashkimi Kulturor Arbëresh” di Spezzano Albanese, che ringraziamo per la collaborazione.

INDICE

Dheljëpra e korbi	3
<i>La volpe e il corvo</i>	69
Uljku e delja	4
<i>Il lupo e la pecora</i>	70
Kapuçkuqi	5
<i>Cappuccetto Rosso</i>	71
Vullau e motra e matrija	7
<i>Il fratello, la sorella e la matrigna</i>	73
Shën Mërtiri	9
<i>San Martino</i>	75
Kapëbrigenti	11
<i>Il capobanda</i>	77
Brigentët	12
<i>I briganti</i>	78
Katër vullezërit	14
<i>I quattro fratelli</i>	80
Borabardha	16
<i>Biancaneve</i>	82
Jugalli ç'i shet petkun Zotit Krisht	18
<i>Iugale che vende il tessuto a Gesù Cristo</i>	84
Jugalli e Dollorata	20
<i>Iugale e l'Addolorata</i>	86
Maçja e miu	21
<i>La gatta e il topolino</i>	87
E jëma e Shën Pjetrit	23
<i>La madre di San Pietro</i>	90
E bukura me illin e arët te balli	24
<i>La bella con la stella d'oro in fronte</i>	91
Tre motra çote	28
<i>Tre sorelle stupide</i>	95

Një búrr, një ghajdhúr e një delje e llatërat	29
<i>L'uomo, l'asino, la pecora e i ladri</i>	96
Maçja e miu	31
<i>La gatta e il topo</i>	98
Prralleza e Kapuçetit Kuq	33
<i>La favola di Cappuccetto Rosso</i>	100
Dheljpra e uljku	35
<i>Il lupo e la volpe</i>	102
Qiqërelja	36
<i>Cecina</i>	104
Fjaljë t'urta	38
<i>Proverbi</i>	106
Fjaljë t'urta	39
<i>Proverbi</i>	107
Scioglilingua	40
<i>Scioglilingua</i>	10
Scioglilingua	41
<i>Scioglilingua</i>	109
Proverbi	42
<i>Proverbi</i>	110
Proverbi	43
<i>Proverbi</i>	111
Scioglilingua	44
<i>Scioglilingua</i>	112
Prralleza e lлиндernës	45
<i>La favola della lanterna</i>	113
Di vullzërit e brigentët	50
<i>I due fratelli e i briganti</i>	119
I vdekuri te tavuti	52
<i>Il morto nella cassa</i>	121
Tre vullzërit	53
<i>I tre fratelli</i>	122
Uljku e dheljpëra	54
<i>Il lupo e la volpe</i>	123

Sinjon Rosi	55
<i>Il signor Rossi</i>	124
Di shók	56
<i>I due compagni</i>	125
Një búrr e ghajdhurët	57
<i>Il padrone e gli asini</i>	126
Pjerini e fiskjata	58
<i>Pierino e la fischiata</i>	127
Mallufati e Mallupagaturi	59
<i>Il Malfattore e il Malpagatore</i>	128
Shën Roku e Shën Pjetri	62
<i>San Rocco e San Pietro</i>	132
Kumpà Skudhati	63
<i>Compare Coda-mozza</i>	132
Kush nëng shërben, nëng hà	65
<i>Chi non lavora, non mangia</i>	135

Albanese

DHELJPRA E KORBI

Një hér ish një dheljpër e kish shum pitit. Allura venej nxhiru sa t'gjënej gjë sa t'hanej e xhirarti, xhirarti pakund ditë e ng'gjet fare gjë. Dhopu pá nj'zog, një korb te një arvur e kish një cóp djáth ç'ish e hanej. Tha:

- Uuú, sa i bukur jé! Vet se ngë di e këndon e kuindi t'ruvinarën beljicën. Ai tha:

- Ndëç do t'shohëç se si jam i bukur, kështu dí e këndonj: Kva, Kva, Kva...- e ljeu djathët pósht.

- Ajo dheljpëra rrëmbeu djathët e ja fillarti. Allura korbi u vú e thrrít se i kish ngrën ata djathë, ma dheljpëra ja ngudhirën e tha:

- E pé e ng'e shè më!

Narratore: *Cosimo Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 14 anni. - Istruzione: III media - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 1.VIII. 1968.*

ULJKU E DELJA

Një hér ishin një uljk e një delje, një shtjerr e ván t'dija te një ljum t'prijën új. Uljku u vù më ljárt e shtjerri ju vù pósht. Dhatu se ujit ish qaru, uljku i tha shtjerrit:

- Oj ghuanjú, si jé e m'llurdon ujit!?

Rrispendoi shtjerri, tha:

- Si mund t'e llurdonj ujit ndë çë ti jé më ljárt e u jam më pósht?

Ai kish gjetur një skazun sa t'e hanej shtjerrin. Ora uljku ju rraxhua.

Tha:

- Nanì ti m'thua se u jam i shtrëmbur?

Allura uljku u vù e ja ngudhirti shtjerrin, e arrëvoi e e rrëmbu, i këceu ngráh e e hëngër.

Narratore: *Cosimo Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 14 anni - Istruzione: III media - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 1. VIII. 1969.*

KAPUÇKUQI

Një hér ish një vashëz ç' i thojën Kapuçkuqi, pse nana i kish reghallatur një kapuç ç' e mbanej sempri ndë krie. Një dít e jëma e thritti e i tha:

- She' se ke t' marrç këta të ngrën e ké t' ja qellç nanës. Però rrì akortu se udh-e-údh është një uljk e mund t' há. Tha:

- Va beni. - e iku.

Arrëvoi te voshku e gjet ca ljlulje të kuqe, xhallo, e u vú e i mbjodh. Duall uljku, tha:

- Vasheré, ç' je bën atì?

- Njó, jam e mbjedh ca ljlulje se kam ja qellinj nanës bashk me këta të ngrën. Tha:

- E ku rrì nana? se dua t' vete e gjënj puru u? - tha.

- Rrì këtje prapa.

Allura uljku e sallutarti e iku më nj' here se nipja, kjo vasheza. Iku e vate te nana e batirti derën. Bëri vuxhën e nipes. Nana e hapu derën. Si e hapu, i kéceu ngráh e e hëngër. Arrëvoi kjo vasheza e i qelli të ngrënit nanës e batirti. Tha uljku:

- Kush është?



Panorama di Spezzano Albanese

- Jam jot mbes. Hapëm.
- Uljku hapu derën e hiri kjo vasherelje. Tha:
- Aë, nà, ké ca sí t'madhëra!
- Ëh, sa t'ruanj më mir.
- Dhodu dhe një cík tha:
- Ké ca vësh të gjata.
- Sa t'gjegjinj më mir.
- Dhodu tha:
- Ké ca thonj të gjata.
- Sa të rrëmbenj më mir.
- Dhodu papana tha:
- Ké një grík e madhe. Tha:
- Sa t'há më mir...

I kërceu ngráh e e hëngri. Allura e jëma ng'e pá se sa t'vinej e dërgoi nj'kaçatúr. Ai arrëvoi e gjégg një rrémúr mbrënd te barku i uljku. Rrëmbenju kët uljk e e qelli ku ish ca új te një voshk e e hapu te barku e kështu duall kjo kriatúr me nanën.

Ringracjartin kët kaçatúr e iktin. Ai muar ljëkurën e këtij uljku e vate nd'katund.

Narratore: *Cosimo Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 14 anni - Istruzione: III media - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 3. VIII. 1969.*

VULLAU E MOTRA E MATRIJA

Një hér ish një búrr e kish dí kriatúr e e shoqja i kish vdekur. Ki këtu vét nëng mund rronej. Mbet pakund e pakund e u martua me një matrie e cilja kish di bílj. E biljat e tij bëjën e bëjën pakund shurbise e ata di biljt e sáj sa bin e rrijën. Një díť si ish e hajën mb'tries, i tha t'shoqit:

- Ti ké t'marrç di kriatúr këtu e ké t've' t'i ljëç te voshku!

I jati allura i tha atire:

- Vemi te voshku!

Ata di kriatúr nanì ván te nana e i thán:

- Tata ka t'vinj t'na ljërenj te voshku, ëmna gjë!

Nana i dha ca koqe qiqra, tha:

- Ju kur mirrni udhën, shtini koqen. Koqen qiqër.

Arrëvuar te voshku, i jati i tha:

- Ju rrini atì, se u jam e vet'e marr drút e vinj e ju marr.

Ai vat'e muar drút, ma atà ng'vate i muar. Iku. Iku ai e ata kriatúr qindruan vet-vét. Po pse kishin shtun qiqrat, e muartin udhën e ván papana mbrënda e ju vún prapa derës, se kishin turp sa t'hijin, e ata ish'e hajën. I jati, pse kish qindruar një cík pást, tha:

- Hè! nanì nd'ishin ata di kriatúr, e hajën...

Ata ishin prapa derës e ju përgjegjtin:

- Njó, ku jemi, ndë do t'na e japç!

E hitin. Hitin e e shoqja i bëri pakund guérr atij e i tha pakund shurbise. Tha:

- Nji kështu vajte i ljeve te voshku? Ké t'veç i ljëç çë ngë shihen më!

Allura papana ai niset e vet'i ljen çë ngë shihen fare më. Atà më pár ván te nana e i thón:

- Tata ka t'vínj t'na ljërenj te voshku, ëmna gjë!

Nana i dha një cík miell e tha:

- Njó një cík miell, qiqrat i fërrnova!

Nanì ish ajri e si do e shtijën, ja mirr, e buartin udhën... Prá i vullau ish e digjej eti. Tha:

- Nanì ruami ndë gjëmi gjë új e vem'e pimi.

Arrëvuar te një voshk e ish një krua i madh me ca kóc se ç'binej új pakund. Tha:

- Nanì vet'e pí ndutu këtù - tha - Vem'e pimi!

Atjè më pár se t'pinej, një kóc i tha:

- Kush pì këtu, bëhet një sisëljóp...

Nanì ai nëng piti se ju trëmb. E motra tha:

- Mos pì, mos pì!

E nëng piti. Ectin njetër cìk e gjetin njeter krua e njeter kóc çì tha:

- Kush pi këtu, bëhet nj' gjalpër...

Nanì ai nëng piti se ju trëmb. E motra tha:

- Jo, jo, ng'ké t'píç!

Prá arrëvuan te njeter krua.

- Vem'e pimi këtu!

Njeter kóc i tha:

- Kush pi këtu, bëhet ghajdhúr...

- Jo, mos pi! - i tha e motra.

E ngë piti. Arrëvuan te njeter krua.

- Vem'e pimi këtu! - tha.

Më pár t'pinej njeter kóc i tha:

- Kush pi këtu, bëhet deljarelje me sí e arta, hundën e arët, këmbët e arta, bishtin e arët, ljeshët e arët... gjithshè t'arët.

Allura ai i vù e piti pse ish e digjej eti. U vù e piti e u bë deljarelje me sí e arta, bishtin e arët, qimet e arta... gjithshè t'arët. Nanì motra kish një xigarelje e kuqe te sutana, e nxuar e ja vù te kanaroci... E pra ju përpoq një prinxhëp kësaj vasharelje e ju martuan.

Ata ján atjè e na jemi këtu.

Narratrice: *Rosetta Bartolomeo - Paese: Spezzano Albanese - Età: 9 anni - Istruzione: IV elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunna - Data della registrazione: 8. VIII. 1967.*

SHËN MËRTIRI

Një hér ish një mëm e kish një ghuanjún, vet'një bír, allura ki ghuanjún kur u rrit, ng'bënej mír, venej tue kalluar, venej tue bën sembri rrovín, t'shtrëmbra... Allura arrëvoi a na çerta età e ju pindír ka ata ç'kish bënur e venej konfesarej sa t'skollparnej dei pekati se ç'kish bën. Allura gjith priftërat kudò venej konfesarej thojën:

- Ma këta ng'kish t'i kishe bën... ma bërë malle sa t'bëje këtë...

Ki tëndirej më i sfutirtur edhè, ai i vrit këta priftat që thojin kështu. Allura vate te njeter e e vrau... Vate t'konfesarej papán te njeter. Kish gjetur një prift se çdo i thonej ai, thonej:

- E bëre mír, e bëre mír, e bëre mír...

Allura ljurtëmu i tha:

- Nanì pënzarej mír: Atë që ngë do për tij, mos ja bëj mëngu tjetvet!

Allura ki këtu e ringraxjarti priftin e iku. Iku e vate mbrënda, arrëvoi natën një thëtim, binej bór. Doj t'batirnej tek e jëma. Ma nanì ngë batirti se thonej:

- Ndë ç'isha u, u ç'ish'e fjëja, e t'm'batirjën, bine ngrëhësja ka shtrati... E kështu ng'ka batirinj sa t'm'mos ngrëhet mëm... - e mbet te dera. Ng'ish aq brutu.

Mbet te dera, njer'se ç'ju dé ka thëtimi që bënej, u xhillár e vdiq. Kúr e jëma ju ngrè prapa t'e hapu derën, si hapu i rá i biri mbrënda. E jëma, e shkreta, kur pá ashtu se i biri ra i vdekur mbrënda, ju trëmb ka lla llexhe, merr të birin e e subëllirën mbrënda mbë shpit, atì që kishën një but me vér. Nxuar butin e nënë subëllirti të birin, e vún papán butin. Allura kur zú butin me vér, ki but ngë fërrnohei máj. E zú te muoji i Shë Mërtirit, e ki but ngë fërrnohej... Sikè dhopu rregji ju adunár:

- Ma insóma - tha - ki but me vér ngë fërrnohet maj - tha - që bën? Tha: Gjé ësht!

- Eee - tha - u dí... - tha.

- Allura si ësht llu fatu?

E jëma dhopu xhà si dinej, do t'ja thonej. Tha:

- Ndë doni e dini - tha - u një menatë që binej bór, që bënej thëtim, ju ngeva, hapa derën e m'rá im bír vdekur mbrënda... Allura - tha - t'mos t'vij ja thój alla llexhi, mora t'im bír e e subëllirta këtu mbrënda ku kishim butin.

Allura kavartin atje e gjetin të birin ç'ish i vdekur. Si e nxuartin atjè nën, e sualltin e e subëllirtin te një qísh e e bën Shënjt, Shë Mërtiri.

Dhopu që nxuartin Shënjtin, buti me vër që ngë fërrnohej máj, ju fërrnua. Rrjodh ata se ç'ish xha pjót e dhopu ju spiçár.

Narratrice: *Maria Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 17 anni - Istruzione: III magistrale - Genitori: ambedue albanesi - Professione: studentessa - Data della registrazione: 3. VIII. 1968.*



Costume di gala (*llambadhor*) di Spezzano Albanese (1940)

KAPËBRIGENTI

Nj'hër ish propriu një nán ka t'mëmës t'ime e vejën e qërojnë grúr ngambanja. E allura kjo këtu ish me katër kopilje, një kopilje ish propriu mëma ime, e ván ka Guri i Madh, ç'është një ngambánj çë thirret ka Guri i Madh këtu Spixan. Ván atje, ndër mend se ç'ju vún se sa t'shurbejën, po i duall një búrr anxian. Tha:

- Di çë t'thóm? Mirr këta kopilje e ik, se njëër nd' arrëvon kumbanja ime e ng'e dimi si vjen e fërrnon...

- Uuú, shólj, - bëri ajo - Kush je?

- U jam kapëbrighenti. Nanì arrëvonjën gjith tjerët brighent, ç'është kumbanja ime e dí u si e pënjarën çë ké gjith këta vashez këtu. Ké katër vashez... E di çë t'thom u? T'dua mír - tha. Mirr këto vashez e ik!

Allura kështu bëri nana, na ndje Zot! Muër ato katër vashez e iku e nëng ván fare më dhopu atje se sa t'qërojën grúret, e ljërien pá qëruar. U mbjodh mbrënd te shpia e tha:

- Ç'patirtim, Marija ime! - i tha të shoqit.

- Ç'partirtit? - i tha i shoqi.

- Na duall një brighent atje ngambánja ka Guri i Madh e bin e mora këta vashez e bin e ika se na desh mír kapëbrighenti, njëmos kish arrëvuar gjith grupi i brigentvet, gjith kumbanja e ngë dí fare se ç'suçedirnej atjè.

E kështu dhopu ng'ván më t'e qërojën ata grúr.

Narratrice: *Maria Leccadito* - Paese: *Spezzano Albanese* - Età: *17* - Istruzione: *III magistrale* - Genitori: *ambidue albanesi* - Professione: *studentessa* - Data della registrazione: *3. VIII. 1968.*

BRIGENTËT

Një hér ish i jati me t'biljën e vejën te një markat, allura i tha s'biljës:

- Kemi kët pend që e menát vem'i shesmi.

U nistin e ván te markati menátnet. Kur ish'e vejën, brigjentët ishin te voshku të fëshehta, e i pán këta ç'ishën e vejën. Allura i pritin kur prirshin. Nanì ata ván, shitën qét. I jati solldet ja dha së biljës. Tha:

- Vëjoji ti.

Ajo i shtu mbë qísh solldet. Kur arrëvuën all punto atjè se çë brigjentët i prisjën, muartën brigjentët e vrán t'jatin. Kjo vasheza, e bilja, iku. Iku, ma t'jatin e vrán. Ku vete fërrnon, e ku ng'vete fërrnon, sa xú te shpija e brigjentvet atje te voshku. Vate atje tue kjár. Ata i thán:

- Ç'ké? Ç'ké? Tha:

- Ora ç'kam? M'vrán tatën. Na vám e shitim qét te markati, brigjentët m'bën ghuardjen tatën ndë se kish ai solldet. E ku? Se solldet i kisha u. I shtura te qisha...

E shoqja e brigjentit, tha:

- Qetu, qetu, ec u hip ljárt!

U hip ljárt te tavullati. U hip atjè, ndërmend ju mbjodhtin brigjentët, t'gjith t'raxhuara. Tha një:

- Ç'patirim sot!

- Ç'patirit? - tha e shoqja e këtij brigjentit.

- Shkuan i jati e e bilja e ván te një markat sa t'shisjën ca qué. Kur ju pruartin, na i pritim ndëç solldet i kish i jati, mbeçi solldet kish t'i kish e bilja, se na vrám t'jatin e sollde ngë kish.

Xhusto papán e shoqja tha:

- Rrì qetu, se e bilja është këtu, është ljárt - tha.

- Si ë këtu? Si ë ljárt? Ku është?

- Ë këtu, ë këtu! Ljárt te tavullati.

Ai i shoqi ripararti një kusí me új të ziër se kish t'e shtijën përmbrenda kët vashez e kish t'e vrisjën. Kjo ka tavullati ruanej atë çë bëjën ata e dinej gjithësè. Kur pá ashtù, ish një finestër te tavullati, muar e ju shtú ka finestra. Ju shtú ka finestra e venej tue kjár. Udh-e-údh, u përpoqtin karabinierët. Tha:

- Ru, ru një çót, rú.

Rispëndoi kjo këtu, tha:

- Ngë jam çót, jo, se mua m'vrán tatën... Ngë jam çót.

- E kush t'e vráu tatën? - tha karabinieri.

- Thuaj, kush t'ë vráu? - tha jetri.

- Kështu e kështu e kështu... ajo i rrifiejti gjith llu fatu si ván te markati t'shisjën një pénd qé, si ja vrán t'jatin brighentët te voshku, si iku te shpía e brighentëve, si u hip ljárt te tavullati, si kish t'ë vrisjën mbrënda kusín me új të zierà e si iku...

- Nani ngi e na mbësoj shpín, se vemi i gjëmi na.

Ván atje. (Ata kridthirtin se edhè ish ljárt te tavullati kjo vashez). Atë e fshehtin e ata hipin mbrënda. Tha:

- Ç'kin bëni me kët kusí me új këtu?

- Kem vrasmi derkun...

- E ku e kini? - tha:

- E kemi... e kemi... jo, kém ngrëmi buken...

- E miellit ku është?

- Miellit...? Miellit...?

- E at'vashez çë vút te tavullati? Nani ku ë? - tha.

- Uuú... tha - na na ngë dimi gjë... Na ngë dimi gjë se ku ë.

- Si ngë dini gjë?

- Ngë dími gjë, ngë dími...

Muartin allura e sualltin vashezën. Tha:

- Njo, kjo këtu është. Pse e pat'i vrisjët t'jatin? Se ç'ishin t'nëmura, ván e shitin nj'pend qé për bëzónj, ju muartit e i vrát t'jatin...

Allura rrëmbeu këta... rrëmbeu t'shoqen e tjerët brighent ç'ishin atjè e i sualltin nd'filjaqit e kështu sallvuan puru kët vashez se njëmos e kishën vrár puru atë.

Narratrice: *Maria Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 17 anni - Istruzione: III magistrale - Genitori: ambedue albanesi - Professione: studentessa - Data della registrazione: 3. VIII. 1968.*

KATËR VULLEZËRIT

Nj'hër ish një tát me katër bilj e ish po të vdis. Allura gjith të t'biljët ván nguqa shtratit e i thojën:

- Tà, mua çë më lje? - i thój i pari.

- Tij të ljé fikun e zí. - i tha i jati.

- Oj ta', e mua çë më lje? - i thój i diti.

- Tij të ljé fikun e bárdh.

- E mua çë më lje? - i thój i treti.

- Tij të ljé fikun natalliz.

- E mua çë më ljé, oj ta'? Çë më lje mua? - i thoj i ljurtëmi, më i voglji bír.

- Tij çë të ljé, biri im? Të ljé një maçe... - rispëndoi i jati e vdiq...

Prá kur erdh moti i fiqvet, allura këta vullezërit ván e mbjodhtin fiq me çistën. Ai çë kish atë fikun e zí, mbjodhi ca fiq me një shpórt e vate te një katund t'i shit. Thój:

- Kush do fiq të zeza?! Kush do fiq të zeza?!

Ju pirpoq një pjak, ç'ish Zoti Krisht, e i piejti këtij ghuanjúni:

- Ç'ké, ti bír, atì! - rispëndoi ki.

U përgjegj allura Zoti Krisht e i tha:

- E fare gjë ng'ké t'kéç!

Prá vate më përpara ka ki katund e thërrit papán:

- Kush do fiq të zeza?! Kush do fiq të zeza?! Ján sapuritra!

Ván gjindjat kush me taljurët, kush me shpórtat, ván atje se t'bjejnë fiq.

- Ëm një gjimbs killi fiq! - i tha njeri.

Ki vate sa t'i mirr e ng'ju gjënd fare gjë te shporta... Ishin bierr gjith fiqët... Allura këta i thán njëqind e një...

Prá váte jetri vullá, çë kish atë fikun e bárdh. Mbjodhi ca fiq të bardha. Vate me një çist mb'katund t'i shit e thój:

- Kush do fiq të bardha?! Kush do fiq të bardha?!

Ju përpoq një të hër ai pjakariq, ç'ish Zoti Krisht, e i tha:

- Ç'ké atì, ti bír?

- Fare gjë! - rëspëndoi ki. Ng'kam fare gjë!

- E fare gjë ng'ké t'keç, biri im! - i tha papán atíj, ki pjakariq, Zoti Krisht.

Prá vate mb'katund e thërrit, ván gjindjat me çista e kur pán çë ngë kish fare fiq, muartin e e rrahtin e u mbjodh puru ki mbë shpít pa fare gjë.

Vate allura i treti vullá, ai çë kish atë fik natalliz. Mbjodh një çist me fiq e vate mb'katund e thërrit:

- Kush do fiq natalliz?! Kush do fiq natalliz?!

Ju përpoq papán ai pjakariq, Zoti Krisht, e i tha:

- Ç'ké këtu? Ç'ké, biri im?

I rëspëndoi ki ghuanjún, ç'ish i treti vullá e tha:

- Kam fiq natalliz, ljà! I do një pár? Ján aq sapuritra, mirri! Ján aq!

- Jo, bír, nëng i dua, - tha - ma tij t'u gjëndët ár e brillande! - i tha Zoti

Krisht.

Prá kur vate sa t'i shit, thërrit papán ki ghuanjún:

- Kush do fiq natalliz?! Fiq natalliz frisku! Ján aq sapuritra...!

Ván gjindjat me bastune t'e rrihëjën... ma atij te çista ju gjënd ár e brillande... Prá ai i shiti këta e muar pakund sollde e ju bë shum i bégát...

Të katërtit vullá, ç'i kish lje i jati maçën, maçja ng'i jip fare útull, një dít i spovisi e qëndroi vét. Nani ki vulláu çë kish shum sollde e ndihu se tha:

- Tij tata t'dhà maçën, çë ng't'jip útull... - e ndihu, i dha pak sollde.

Prá një mbrëma ki i katërti vullá ëndrri t'jatin ç'i dhà ca numra e i tha:

- Ti ec e ljuaj te dadhet se vinxhirën shum sollde...!

Ki allura vate e ljuajti, bëri ata numrat te dadhet e vinxhirti pakund sollde. Prá nga dita venej te kambësandi të gjënej të jatin e e ringraxjarnej, e puthnej e prëgharnej për atë.

Ata ján atjè e kán sollde, na jemi këtu e kemi shëndet.

Narratrice: *Maria Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 17 anni - Istruzione: III magistrale - Genitori: ambedue albanesi - Professione: studentessa - Data della registrazione: 3. VIII. 1968.*

BORABARDHA

Një hér ish një grua e ish e righamarnej llunxoljet. Ish e binej bór, se ish dimër, e ajò tha:

- Ruani karrocat gjith me bór!

Si tha kështu, i vate giljpëra te gjishti e i rá një pík gjak e madhe, ç'dualli te llunxualli, gjith i kuq ju bë. Pëstaj vat'e muar ca cinxulla e e ljidhi. I thán:

- Ç' bëre? Ç'bëre?

Ajo tha?

- Shpova gjishtin e m'duall gjak.

Ajo gruaja ish e martuar me një prinxhëp çë prá vdiq. Vdiq e kish ljën një kriatúr çë ja thojin "Borabárdh". Kjo kriatúr ish e bukur. I jati, ki prinxhepi, ju martua me një rrëxhín e ajò ish edhè e bukur, e do t'mbahej e bukura e dheut, po "Borabárdha" ish më e bukur se ajò rrëxhina. Kjo venej te speqi e i thonej:

- Speq, speq, kush është më e bukur, "Borabárdha" o u?

- Është "Borabárdha" më e bukur! - rrispëndoi speqi.

Ajo muar e çajti speqin e i tha prinxhëpit:

- Ti ké t'veç e vraç "Borabardhën" e zëmren ké t'm'e siellç këtu!

"Borabárdha" nanì kjanej, dinej se kish venej t'e vrit. Atij të jatit i dispëlqenej e ngë vat'e vrau. Vat'e vrau një dhí e i muar zëmren e dhís e ja qelli s'shoqes e kjo i tha:

- Kjo nëng është zëmra e asáj "Borabardhës", kjo është një zëmër dhíje!

E muar e e shtú jásh. "Borabárdha" vate te një shpiarelje ku ng'ish mosnjerí, po ç'rrijën shtat nanulliqra. Vate atjè e hëngër një cík pást, piti një cík vér... te gjith taljúrèt e shtat nanulliqravet. Pra ish e i vinej gjúm e vat'e fjëjti. Erdhtin shtat nanulliqra, vejën sa t'hajën e njeri thonej:

- Kush m'ngau taljúrín t'im?

Jetri thonej:

- Kush m'piti verën t'ime?

Jetri thonej:

- Kush m'muar mollën t'ime?

Jetri thonej:

- Kush m'muar bukën t'ime?

E gjith fjisjën... Ván te shtrati e gjetin "Borabárdhën".

- Sa e bukur! - thán.

- Po ng'vemi e zgjomi!

- Jo, ng'e zgjomi, mos trëmbet!
Ajo prá u zgjua menatvet e tha:
- U, ku jam? Kam ikinj pse m'vrasën!
Ata thán:
- Jo, kush të nget? Këtù ti ké t'rríç me né! Ti na bën kallucjet.
- Ti na ndërton shpín...
- Ti na zien... Ti na bën gjithëse'...
E mbet. Prá një dít ish e qepnej e shkoi e matrija ç'donej se kish t'vdis
“Borabardha” e ç'i donej zëmrën. I tha:
- Si rri?
- Ë, rrí mír! - tha. Jam e vet'e e fjë...
Prá fjëjti e i arrëvoi një çíst gjith molla, e “Borabardhës” i vú një móll
të mbillinartur. Ajo ju zgjua e e hëngër. E hëngër e vdiq e rá mbë truall.
Erdhën shtat nanulliqra e thán:
- Ku ë? Ku ë?
E gjetin të vdekur e prá ju vún e kjahtin pakund. E njeri thonej:
- Kem'e vëmi këtu!
Njetër thonej:
- E vëmi tek ai qeljqí, se kështù e shomi sembri!
Prá shkoi një prinxhep e me drurin e fatartur e ngau e ajo ju zgjua e ju
martuan...
Shtat nanulliqrat i thán:
- Rrini këtu!
- Jo, shpín u e kam nguqa këtù! - rrispëndoi “Borbárdha”.
E mbetin atjè. Prá ajo venej nga dita te shpia e shtat nanulliqravet e i
bënej shurbiset e ju deshtin mír. Pra matrija, maghára, vdiq e
“Borabárdha” qëndroi e martuar e me shtat nanulliqrat.
Ata ján atjè e na jemi këtu.

Narratrice: *Giuseppina Pesce - Paese: Spezzano Albanese Età: 10 anni - Istruzione: IV elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunna - Data della registrazione: 10. VIII. 1967.*

JUGALLI, Ç'I SHET PETKUN ZOTIT KRISHT

Një hér ish një mëm e kish një bír një cik çót ç'i thójën ç'e thrisjin Jugall. Nanì ki këtu një hér kish t'shít një trëmb petk. Kish t'shít një trëmb petk e vate te markati. I jati i tha:

- Ec te markati e shite.

Nanì sikome e dijën se ish një cík çót e se mund e mbruljájën, se mund e mirtjën për çót, i jati i tha:

- Ti ké t'ja sheç atire gjindve çë ngë bënjën shum fjálj, se këta njëmos dhopu t'mbruljarnjën. Ata t'mbruljarnjën me fjálj e t'marrën petkun e ngë t'japën solldet. Tha papán:

- Ti ké t'ja sheç atire gjindve ç'i jep petkun e t'japën solldet pá bër fjaljë, mbjátu.

Ki këtu, vate te markati e pá gjith këta gjind, gjith kët çiróm, gjith ç'fjísjën... Kush bjenej, shisjën... gjith këta soje çë bëjën çiróm, fjísjën. Insóma ngë desh t'ja jip, ju trëmb. Ka fjaljën ç'i kish thën i jati e ngë desh t'ja jip sa dò. Tha:

- Këta këtu m'mbroljarnjën e ng'm'japën solldet...

Allura iku ka markati. Iku, ma papán mbanej petkun te gradha e venej tue xhirartur ndë katund sa t'shíh ndë ç'mund t'gjëj ndo' njerí. Po kur ish e mbjidhej, shkoi ka një qísh. Shkoi ka një qísh e hiri mbrënda, pá se ng'ish mosnjerí, ish gjith, gjith qétu, kallmu, pá një statue t'Zotit Krisht mbë kriq. E pa xhakaran, tha:

- Ma tíj ngë t'bën thëtim? Pse rri i xhësht kështu? Se t'e shes tíj kët petk?

Ai fjit e Zoti Krisht ng'i rispëndonej. Tha ki:

- Ki këtu është ai çë bën për mua. Kuindi këtij këtu ja shes u, si m'tha tata.

Allura tha:

- Se u t'e ljënj këtu sipër petkun. Menát vinj e m'jep solldet.

E ai ngë rispëndonej... E kështu muar e iku. Menátnet apriesu vate papán te qisha, te Zoti Krisht se duaj solldet e e gjet papán xhakarán, pa petk e petku mbë truall ng'ish atjè.

- Pse? Ng'ish mosnjerí. Kush e di? Mund t'e kan márr, mund t'e kan kalluar, e ka márr ndonjerí, sakrëstani o ndonjeter... E kan márr... Allura tha:

- Ç'e bëre? - i tha Zoti Krisht.

- T'dhé petkun e nëng ju veshe... Ku e vure? U nanì dua paguajtur. Dua paguar!

Ai ngë rispëndonej. Ngë rispëndonej e papán ja ripetirti, ja tha papán:
- Ç'e bëre petkun? Dua paghuar! Shè' se dua solldet nani! Shih ku i ké solldet, e nxiri!

E ki këtu, Zoti Krisht, papán ngë rispëndon. Po ki ju rraxhua, Jugalli, ju rraxhua, ju ngacár e muar një drú, një macóll, një drú i madh e muar e ja ngjoku te koca... ju kish rraxhuar. Tha:

- Nani, va bene se ngë fjet, ma fino a kuesto punto... nj'her ktë e nj'her atë... nani ké t'fjáç, ké t'm'i japò solldet! M'i jep solldet?

Ai ngë rispëndonej e e muar e ja ngjoku te koca. Ja ngjoku te koca e atje ish karuzjelji, ç'kishin vun solldet t'krishterët, ata ç'vëjën, vëjën solle e gjë... e u kish mbjuar karuzjelji e ish pjot me solle. Si e ngjoku e muar e ja çajti kocën e rán gji' solldet mb'truall e i muar e tha:

- Aaa, nani i kische solldet! Nëng dój t'm'i jipje! Ishe më i shtrëmbur se tjerët. Tjerët maghari forse fjisjën e forse m'i kishin dhën. Ti né fjisnje né solldet do' m'jipje e i fshehje.

Kështu muër solldet e iku. Tha:

- E shè' si patëm paguaje? T'çajta kocën!

Narratore: *Raffaele Fera - Paese: Spezzano Albanese - Età: 30 anni - Istruzione: universitaria - Genitori: ambedue albanesi - Professione: insegnante - Data della registrazione: 2. VIII. 1968.*



Notabili spezzanesi (1925)

JUGALLI E DOLLORATA

Ish një ghuajnún ç'ia thojën Jugáll, e kish t'shít ca tull. Allura vate te markati. Tha:

- Kush bën shum fjalj, ng'ja jap.

Vate një grua. Tha:

- Sá rrì këta tull?

- Ik, ik se bëre xhà shum fjálj!

Vate njetër grua. Tha:

- Sá rrì këta tull?

- Ik, se bëre shum fjálj! Nëng t'e jap!

Allura vate mbë qísh te Dollorata. Tha:

- E do këta tull? Però vinj menát e ka t'm'japç solldet!

Ajo nëng fjit. Ai e ljeu e iku. Sakrëstani vate e e nxuar tullën. Jugalli vate menátnet e mbjoi kusheljët pjot me fiq. Një kusháll me fiq të ngurta e një kusháll me fiq të njoma. Dhopu vate te Dollorata. Tha:

- I prepararte solldet? Ku ján solldet?

Ajo nëng fjit e ai i dhezi gjith ata fiq të ngurtat, dhopu i dhezi ata të njoma e u mbraqartin. Ai tha:

- Aaa, si dit'i skartarni fiqët! Ata të njoma i merr ti - tha -, ata të ngurtat m'i jep mua!

Narratore: *Giuseppe De Marco - Paese: Spezzano Albanese - Età: 11 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 5. VIII. 1968.*

MAÇJA E MIU

Një hér ish një maçe ç'ish e grriëj dhén. Zgavarti, zgavarti e gjet një solld. Zú e tha:

- Ç'kam bjénj, nanì me kët solld? Ç'kam bjenj? Bjénj një árr, e kam shtie korqën. Bjénj një mjendull, e kam shtie korqën. Bjénj fiq, u kam shtie korqën. Bjénj një karamelje, e kam shtie kartën...

Pënxarti e pënxarti mír mír e tha:

- Bjénj një çúf t'kuqe e e vë te koca.

Allura maçja vate bjejtì çufën, e kur u mbjodh mbë shpít e vú te koca. Duall te një ballkun e rrij si një nuse e bukur. Tha:

- Aaá, sá e bukur jam! Dua t'martohem...

Shkoi ghajdhuri nën ballkunit e i tha:

- Zonja Maçe, ç'jé e bën atì me at' çúf të kuqe te koca?

- Jam e rrí sa kam martohem - tha maçja.

- M'do mua për dhëndërr?

- Shomi si e ké vuxhën.

- I-aaá, i-aaá... - bëri ghajdhuri.

- Ik, ik se ti m'trëmbën natnet!

Dhodu shkoi qeni e i tha:

- Zonja Maçe, ç'je e bën atì si nuse?

- Jam e rrí këtu se kam martohem.

- M'do mua për dhëndërr?

- Shomi si ké vuxhën.

- Am-am, am-am, am-am... - bëri qeni.

- Ik, ik se ti m'trëmbën natnet!

Dhodu shkoi delja e i tha:

- Zonja Maçe, zonja Maçe, ç'je e bën atì si nuse?

- Jam e rrí se kam martohem.

- M'do mua për dhëndërr?

- Shomi si e ké vuxhën.

- Mbeeé, mbeeé, mbeeé... - bëri delja.

- Jo, ik, se m'trëmbën natnet. - tha Maçja.

Shkoi gjelji nën ballkunit, pá Maçen ç'rrij atì e i tha:

- Zonja Maçe, ç'jé e bën atì me atë çúf t'kuqe te koca?

- Jam e rrí se kam martohem.

- M'do mua për dhëndërr?

- Shomi si e ké vuxhën.

- Kikirikiíí, kikirikiíí, kikirikiíí... - bëri gjelji.

- Ik, ik se m'trëmbën natnet.

Dhodu një cík shkoi një miariq nën ballkunit, pá Maçën ashtu me atë çúf t'kuqe te koca, si nuse e i tha:

- Zonja Maçe, ç'jé e bën atì me atë çúf t'kuqe te koca? Do martohetç?

- Ëh, ëh, jam e rri se kam martohem.

- E m'do mua për dhëndërr?

- Shomi si e ké vuxhën.

- Ciu, ciu, ciu... - bëri miariqi.

- Hipu ljàrt, hipu.

U hipu ljàrt miariqi e u martuan. Dhodu ç'u martuan, menatnet Maçja ndërtoi shpín, vú poçen me fasulje te zjarri se kish t'venej te qisha. I tha miariqit:

- U vete te qisha e gjegjinj meshën. Ti rri atì - tha - e ruaj poçën. Ma rri akortu e mos u qas te zjarri!

Maçja duall e vate mb'qísh. Miu mbet e mbet atì te zjarri e i vinej ú. Gjet një cík búk e vate e ljàgu te poçja. Hapu kuperqen e ljàgu bukën. E përvoj e ish e mír. Muar njetër cík búk e vate e ljàgu te poçja, pa puf! rá mbrënda e u zie. Kur u mbjodh Zonja Maçe, thritti miun sá t'i hapnej derën, ma ai ng'u përgjegj. Thritti, thritti shumë hér, ma ai ngë përgjegj. Pstana hiri mbrënda mb'shpít ka finestra.

- Miu im, ku jé? Miu im, ku jé?

Ma ai ngë përgjegj. Kërkoi nën shtratit, nën sënduqit... shkararti, shkararti pakund e ngë mund e gjënej miariqin.

- Miu im, ku jé? Miu im, ku jé?

E ngë mund e gjënej.

Allura Maçes i vinej ú. Vú triesën e taljúrín, muar poçen e minestroi se kish t'hanej. Mbrazhi fasuljet te taljuri... Me fasuljet rá edhe miu mb'taljúr. Ma pá se ish vdekur i shoqi, se ish zier mbrënda te poçja. Allura Maçja u vú e kjahti e thonej:

- Miu im, çë patirta! Miu im, çë patirta!

Si kjahti e kjahti, mbet një cóp hér e heljmuar pstana u vú e hëngër fasuljet. Tue ngrën fasuljet, përvoi edhe një shálj të miut. I pëljeu e e hëngër të tër. Kur fërrnoi, tha:

- Ngë bën gjë. Të vdekur o të gjáll, kish t'e haja.

Narratore: *Nicola Libonati - Paese: Spezzano Albanese - Età: 60 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: contadino - Data della registrazione: 3. VIII. 1969.*

E JËMA E SHËN PJETRIT

Një hér ish një grua ç'ish e jëma e Shën Pjetrit e ish shum pirqe, ish avaru. Një dít ish e ljanej ljakrat te ljami e ujit i muar një fjét ljakër. Vate t'e zëj ljakrën, ma ng'mund e zëj. Allura tha:

- Váft për shpirtin t'im! Váft për shpirtin t'im!

Dhodu pak mot vdiq kjo e jëma e Shën Pjetrit e arrëvoi te dera e Parrajsit, tek i biri, e batirti mb'dér: tup! tup!

- Kush është? - tha Shën Pjetri nga mbrënda.

- Jam u! Jam u jot'em! Hapëm!

Ma gjithënjëherje nd'at mumend arrëvoi Zoti Krisht e e shtú te Pisa. Shën Pjetri allura mbet ljug e e prëgharti Zotin Krisht, i tha:

- Ma është mëma ime...

- Ma është e ljug, - tha Zoti Krisht - është aváru...

- Ma ajo ka bën... ka ljën një fjét ljakër për shpirtin e sáj...

- Va beni! - tha Zoti Krisht - Ti mirr atë fjét ljakër ja jep e mbi të je t'ngjitet ka Pisa mb'Parajs...

Shën Pjetri ja shtú allura fjetën e i tha:

- Ec e ngjitu! Ngjitu! Njó, kët fjét e ngjitu përsipër!

E jëma allura zë e ngjitet për fjetën, ma ca tjér ka Pisa do t'ngjitshin pas asáj... Allura kjo, mbidhjuze, shkundi këmbët... Fjeta u këput e rá papana mbë Pisë e atjè qëndroi për sembri...

Narratore: *Nicola Libonati - Paese: Spezzano Albanese - Età: 60 anni - Istruzione: elementare - Genitori: albanesi - Professione: contadino - Data della registrazione: 3. VIII. 1968.*

E BUKURA ME ILLIN E ARËT TE BALLI

Një hér ish një grua me një bílj e u martua me një búrr që kish një vashëz edhe ai ka jetra grua që i kish vdekur. U martuan kjo grua e ki búrr. E shoqja dërgonej sembri të biljën e të shoqit, që ish e bukur e e mír, sa të venej te çibja, e dërgonej me një çíst me mbrolja e me një cikariqe sapun. E ajo e gjegjnej sembri. Kur venej atjë sá t'ljanej, e mbanej me duart sapunt se mund t'ljanëj. Dhopu gjith një herje i shkau sapunt, e ajo nxuar këpucët e u vërngut mbrënda te çibja. Dhopu atjë sparirti gjith ujit e ajo ju gjënd me sít e mbullitur. Atje mbrënda ju gjëndtin gjith maçet e dheut: ato që fshijën, ato që zien, ato që bënej bukët e gjithësè...

Maçja që fshinej gjith jetën ju kish ljodhur sa t'fshinej. Thrriti atë vashareljen e i tha:

- Vjen e m'ndihën se u ju lodha se fshita gjith jetën?

Ajo tha:

- Va beni, se fshíj. - e fshiti gjith kamarat.

Vate te njetër kamar e gjet njetër maçe që ish e zienej. I tha kjo:

- Biljaré, vjen e m'ndihën se u ng'ja rrënj te stufarollja e digjem?

E ajo vate rriminarti pastën e ja ziejti. Dhopu gjet një që ish e bënëj bukët. I tha kjo:

- Biljaré, vjen e m'ndihën sá t'bënj bukët, se u ng'ja rrënj e hapinj ndonj' krah?

Ajo vate e ndihu e bëri bukët. Gjith ata maçe ván e ja thán asaj maçe me stivaljët. Ai tha:

- U dua t'e shoh, se u ng'e kam besë se është kështu.

- Vém' e marrmi.

Ajo kish turp sá t'vanej, njësh vate. Kur hinej te kamara e rregjit, gjet një kamar që kish t'fshinej e një skup ka nj'án. Mbë truall ish pakund pjëh.

Ajo muar e fshiti, fshiti e rregji ish ka finestrini e shih gjithësè. Dhopu hiri te njeter kamar e gjet gjith shtretet pa shtruar. Muar e i shtroi. Hiri te njeter e gjet pakund mbrolja që kish t'stirarnej e hekurin ka nj'án. Muar e stirarti me hekurin gjith ata mbrolja. Dhopu hiri te njeter kamar e gjën rregjin. Ajo i tha:

- Mír dít!

E rregji i tha:

- Hír, hír!

Ajo vate nguqa rregjit. Tha:

- Njó, këtjè ján mbroljat tënde t'stirartura e me copën sapun. Dhopu i tha:

- Kur jé e ikën, ké t' mbulliq sít, e kur thërret delja, ngë ké t' prireç për tre hér, e kur këndon gjelji, ké t' prireç për tre hér. Ajo tha:

- Vete mír! - e muar mbroljat e iku. Po dreq mbulliti sít, bëri si tha rregji. Prá thërriti delja e nëng ju pruar për tre hér. Dhopu këndoi gjelji e ju pruar për tre hér e ngit sembri ballët. Tek e treta ju gjënd një íll i arët te ballet e gjith ata që shurbejën dherat thojin:

- Sa e bukur është! Sa e bukur është!

Kur vate te shpia, matrija ish e e prit te dera e dhopu e vat' e piejti:

- Kush bin e t' u bë íll i arët te ballet?

Ajo vasheza i rrëfiejti gjithëse. Matrija tha:

- Nanì kam dërgonj edhè t' ime bílj.

E e dirgoj me dí o tre skamandilje me një cóp sapun. Ajo vate e ish me faqet pá ljár, nëng bin e ljahëj maj. Vate te çibja e e shtiu aposhtaz sapunt. Dhopu ju shtu mbrënda atjè e gjet papá gjith maçet e dheut. E para maçet i tha:

- Biljaré, më ndihën, se fshita gjith dheun e nanì jam e ljodhur? Ajo tha:

- U u bëra serva juaj? Ngë vinj e ju ndihinj!

E ato të zezat fshitin gjith kamarat.

Dhopu hiri te jetra kamar e gjet atë, ç' ish e rimirarnej pastën. I tha kjo:

- Biljaré, vjen e m' ndihën se ngë mund e rimirarinj pastën se jam shumë vogulj?

- Jo, u ngë jam serva juaj! Ngë mund vinj!

Ajo maçja tha:

- Vete mír.

Dhopu hiri ka jetra kamar e gjet një ç' ish e nburnanej bukët.

- Vjen e m' ndihën sa t' mbaç bukët se u ng' ja rrënj? - i tha kjo.

- Jo, u ngë vini e ju ndihënj. Ngë jam serva juaj!

Dhopu, ata maçet ván e ja thán rregjit se ish një vashez vakabune, që ngë desh të bënej fare gjë. E rregji i tha:

- Ecn' e mirrni, se dua t' e njoh!

Van' e muartin e ish e tiljqjën. Ajo i tha:

- Ljërenmi se vinj vét te rregji - tha. Mos trëmbeni!

Dhopu hiri te një kamar e gjet një skup ka nj' án e kish të fshinej. Ajo nëng fshiti e tha:

- U bëra serva këtu se kam fshíj?! - e nëng fshiti fare.

Hiri ka jetra kamar e gjet shtretet gjith pá shtruar e nëng i shtroi fare e shtú gjith kushinet jásht, llunxoljet e gjithësè'. Hiri ka jetra kamar e gjet hekurin ka nj' án e gjith mbroljat ç' kish stirarnej. Ajo ng' i stirarti fare. Muar e shtú gjith mbroljat jásht e hekurin e shtú mbë truall. Hiri ka jetra

kamar e ish rregji e ng'i tha né "mír dít" né fare gjë. E vate nguqa rregjit si një pést. Ai tha:

- Këtje ján mbroljat tënde me sapunt. Kur është e këndon gjelji për tre hér, nëng ké t'prireç; e kur është e thërret delja, ké t'prireç.

Ajo bëri kështu: kur këndoi gjelji për tre hér, nëng ju pruar. Thërriti delja e ajo u pruar për tre hér e ngit sembri ballët, ma ngë kish fare gjë. Tek e treta hér i duall një bisht delje te balli. E më e mbanej, e më i ngjatej. Prá arvoi mbrënda e e jëma i tha:

- Shomi çiké këtu te ballët, ç'i mban sembri.

Tha vasheza:

- Pundár! Qëndrò se kam një shurbes. Prá bin e e pá. E jëma vat'e muar gërshërët e ja preu. Më prit, e më ngjatej; më prit, e më ngjatej...

Ajo vasheza ç'kish íllin e arët ndë ballët, ish e martohej me një xhuvínót, ma kjo gruaja vat'e vú te kopshti me mít. Dhopu kur arrëvoi dhëndrri, muar biljën saj, atë të ljigën, e i vunë një vell i zí përpara. Dhëndrri ngë bin e e pá fare se ish ashtu e shëmtuame me bishtin e ngjatur te ballët. Kur e vú te karroca, dhëndrri tha:

- Ma u kam e shoh ktë!

Prá u përgjegj e vjehrra e tha:

- Kur mbjidhemi ka mesha bi't'e shohç - tha - ma nanì jo.

E ai tha:

- Vete mír.

Dhopu ish e hipshin te shkalla, një i mbajti vestën prapa. Si shkelji vestën, velli më rrinej e më shkurtohej, kur dhëndrri pá buzën gjith të ljíg, ai qëndroi. Dhopu tha:

- Nanì shomi hundën sá t'bukur e ka.

E e pá hundën e ish gjith e rrapartur e e madhe. Tha:

- Nanì shomi sa t'bukur i ka sít.

I pá sít sa të keq i kish: gjith të hapta e të zgurdhulluara, bin e trëmbëshe. Tha:

- Nanì shomi ballët sa të bukur i ka.

Kur i pá ata báll ç'kishin bishtin, tha:

- Sholja ime, ka bishtin! Ku e dija u se kish bishtin e deljes?! Nd'e kisha ditur, ng'e kisha márr fare!

Dhopu vate e u mbjodh ndë shpí, u mbjodh mbrënda te e vjehërra e tha:

- Ku është ajo ç'ka íllin e arët te balli, ç'është nusja ime?

Ajo i tha:

- U ng'e dí.

Ai vate tue kërkuar e e gjet te kopshti gjith ndë mes të mivet. E muar e e martoi atë e qëndruan sembri me hare.

Atà ján atjè e na jemi këtù.

Narratrice: *Angela Laurito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 12 anni - Istruzione: I liceo - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunna - Data della registrazione: 4. VIII. 1968.*



Benedizione dei buoi - Lunedì di Pasqua (1956)

TRE MOTRA ÇOTE

Një hér ishën tre vashez, tre motra çote çë nëng dijën e fjisjën. Allura kishën vat dhëndrrat mbrënda. E jëma i tha:

- Kur ikinj u, mos fjini shum, se njëmos ata e kapirnjën se nëng din'e fjini.

Allura iku e jëma. E maçja, ish poçja te zjarri, e vate e shtú. Rispëndoi njëra e tha:

- Auú, maçja çajti poçen...

Rispëndoi jetra:

- Te mëkrra...

Rispëndoi jetra edhè, tha:

- Minu mallu se nëng fokrra u!

Kështu fjisjën të tre motrat e dhëndrrat pán se ishin çote, iktin.

Narratore: *Cosimo Leccadito - Paese: Spezzano Albanese. Età: 14 anni - Istruzione: III media - Genitori: ambedue albanesi. Professione: alunno - Data della registrazione: 1. VIII. 1968.*

NJË BURR, NJË GHAJDHUR E NJË DELJE E LLATËRAT

Një hér një búrr ish e venej te markati sa t'shit ghajdhurin e një delje. Udh-e-udhë ënkontron tre llatra. E një ka ata tha shokëvet:

- Do t'skumëtirç se u i kallonj atë delje?
- Do t'e shokç se u i kallonj ghajdhurin! - tha jetri.
- E u i kallonj gjith mbroljat! - tha i treti.

I pari vate nguqa-nguqa, kuetu-kuetu, zgjidhi kambanieljin ç'kish delja e e ljidhi te bishti i ghajdhurit e i muar deljen... Dhopu nj'cík ai burr u pruar e ng'pá deljen e u vú e thërrít, mallkonej... e arrëvoi ki i diti llatër e i tha:

- Pse je rraxhohe e mallkon? Tha:
- Jam e mallkonj pse m'kalluan deljen.

Rrispëndoi ki këtu, tha:

- Ka një cík për një se çë kish... një delje e bárdh me një kurdún e venej ka kjo án...

- E bárdh? Tha:
- Propriu e bárdh!

- Ish delja ime. Allura ish ai llatri se ç'm'e kalloi! Mbaj! Mbajmë këtë ghajdhúr se vete e rraxhunxhirinj!

Kështù ai búrr e ljeu ghajdhurin këtij llatri e u ngudhi si një makën k'ajo án se ç'i tha ai búrr. Ai xhirarti gjith katundin, ma ng'e gjet ne at ghajdhurin ne deljen. I dërsitur si çë dukej një púl, vate ku ish ai búrr ç'i mbanej ghajdhurit, ma ruaj ka nj'án e ka njetër e nëng gjet ne at búrr ne ghajdhurin. Allura gjith i rraxhuar, ish e venej mbrënda. Dhopu edhë një cík njetër búrr, ç'ish njetër llatër, i tha:

- Ooo, eja këtu!

Ai búrr vate e ai e pá ç'ish gjith i rraxhuar e kuazi ç'ish e kjanej e i tha:

- Pse? Ç'ké? Pse je kështu... jé kján?

- Ëëë, - i tha - nëng kisha ardhur mai sa t'u kisha rristurartur një cík këtu te këta új... Tha:

- E pse? Çë të suçëdirti?

- Pse kisha një xájën pjot me sollde t'arta, kish'e konsënjarja rregjit e nanì m'rá këtë mbrënda... Si kam e bënj? Ai m'vret! Tha:

- E pse nëng kallare e e merr? Tha:

- Ndë çë kallarem ai është funu e fukarem... Më mír sa të m'vrasën e jo sa t'fukarem! - Tha - Ma ndë çë gjënj ndo'njerí, vete m'e merr, i rreghallarinj dhjet sollde t'arta...

Ai gjegj kështu e u kallár. Nxuar mbroljat e i ljeu atjè sipër. Si u Kallár, ai llatër i muar mbroljat e këpucët e iku... Ai burr ruanej ka nj'án e ka njetër e ng'e gjet ne at búrr ne mbroljat... Allura rá mbë truall i zvinirtur...

Narratore: *Cosimo Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 14 anni - Istruzione: III media - Genitori: ambedue albanesi - Data della registrazione: 1. VIII. 1968.*



Fonte "Kuvelja"

MAÇJA E MIU

Një hér ish një maçe e zgavarti e gjet një sólld. I tha s'jëmës:

- Me këta ç'kam vete bjénj? Tha:

- Ndutu-ndutu, vete e bjénj një çúf. E bjehti e e vú te koca. U vú te ballkuni. Allura shkoi mbéza nën. Mbéza tha:

- Ç'jé e bën atì? Mos m'do për nuse?

- Homi si e ké vuxhën.

- Mbeeé...

Allura i tha maçja:

- Ik, ik, ik se m'trëmbën natën.!

Allura shloi ljópa. Tha:

- Ç'jé e bën atì? Mos m'do për nuse?

- Homi si e ké vuxhën. Tha:

- Buuú, buuú... Tha maçja:

- Ik, ik se m'trëmbën natën!

Allura shkoi ghajdhuri. Tha:

- Ç'jé e bën atì? Mos m'do për nuse?

- Homi si e ké vuxhën.

- Iaaá, iaaá, iaaá...

- Ik, ik se m'trëmbën natën!

Allura shkoi qeni. Tha:

- Ç'jé e bën atì, ndrikulla Maçe? Mos m'dò për nuse?

- Homi si e ké vuxhën. Tha:

- Baù, baù, baù...

- Ik, se m'trëmbën natën!

Allura shkoi miariqi. Tha:

- Ndrikulla Maçe, ç'jé e bën atì? Mos m'do për nuse?

- Homi si e ké vuxhën. Tha:

- Ciu, ciu, ciu...

Tha maçja:

- Ngít, ngít, ngít ljárt! - e u martuan.

Allura Maçja, vate te qisha. Tha:

- U ljéva poçën. Ti mos ec atjè nguqa poçes, se mos vete mbrënda. Aj tha:

- Va beni.

Kur iku Maçja e vate te qisha, ai muar e çajti një thélj búk e vate sa t'e ljagnej te poça. Allura dreq vate hiri mbrënda te poçja. Kur erdhi Maçja,

shkararti, shkararti, nuk e gjënej. Tha:

- Allora që nëng mund e gjënj, ha qiqrat.

Kur mbrazi qiqrat, e gjeti mbrënda nd'taljur e hëngër atë e qiqrat.

Narratore: *Michelangelo Perri - Paese: Spezzano Albanese - Età: 12 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 5. VIII. 1968.*

PËRRALLEZA E KAPUÇIT KUQ

Ish një hér një grua ç'kish një vashëz ç'i thojën “Kapuçeti i kuq” pse nana, ç'e dúj mír, i rrihallarti një kapuç velluti i kuq ç'e qellnej, e ç'e mbanej sembri te koca.

Një díť ajo e jëma kish bënur bukët e e thërriti se kish véj të qellnej fukacën te nana, ç'ish e smúr atje te voshku. I tha:

- Ké t'véç te nana ç'është e smúr. Ma rrì akortu! Ké t'véç tek ajo údh këtjè, se tek ajo jetra, udha e voshkut, është një uljk e t'hà.

- Èh, èh. - rrispëndoi Kapuçeti, e muar fukaçën e butiljën me qumbshtë e vate iku. Ma ajo vate ka jetra án, ka udha e voshkut, ç'ish uljku, se kish të bënej ljuljet. Penxarti se ish një pinxier i mír për nanën, e vate t'ja bënej. Vate atje te voshku, bëri ljuljet e gjithënjëherje i duall uljku përpara e tha:

- Biljaré, ku jé vete?

- Jam e vete te nana ç'është e smúr. Jam e qellinj këta se bëm bukët.

- Ku është nana tënde?

- Atjè pëtej te voshku.

- Ti ec ka ajo údh aténa se u vete këtena. Shomi kush arrëvon më një here. Bëmi la gara, ti vete ka një údh e u vete ka jetra...

Ai uljku vate ka udha ç'ish më e shkurtur e arrëvoi njëherje te shpija nanës. Batirti te dera: tup! tup!

- Kush është? - tha nana.

- Jam u, Kapuçeti i kuq. Jam u. Hapëm se t'solla fukacën e qumbshtit...
- e bëri vuxhën e asáj vashez.

Ajo kridhirti se ish ajo, Kapuçeti e tha:

- Hír, híř! - tha nana nga mbrënda, ka shtrati.

Uljku hiri. Si hiri mbrënda ka kamara e atje pá nanën te shtrati, njëherje e hëngër. Muar mbroljat e sáj, u vesh e hiri e u vú ai mbë shtrat. Vú uqallë e bëri nanën.

Dhopy arrëvoi Kapuçeti i kuq, batirti mbë dér: tup! tup!

Uljku nga mbrënda bëri vuxhën e nanës:

- Kush është?

- Jam u, nana ime, jam u, Kapuçeti. Hapëm se t'solla fukacën e qumbshtit. - tha ajo.

- Hír, híř se jam mbë shtrat. - bëri uljku ka mbrënda vuxhën e nanës.

Ajo kridhirti e hiri. Vú ata shërbise mbrënda bufetës e hiri ka kamara. Kur hiri atjè, pá nanën ç'u kish kambjartur e e piejti, tha:

- Nana ime, pse i ké këta sí kaq të mbdhenj?

- Sa t'shoh më mír, bilja ime.
- Pse i ké këta vésh kaq të mbdhenj?
- Sa t'gjegjinj më mír, bilja ime.
- Pse i ké këta duar kaq të gjata?
- Sa t'abraçarinj më mír, bilja ime.
- Ç'grík ké të madhe, nana ime!
- Sa t'há më mír!

Uljku ahirna duall ka shtrati e muar e hëngri Kapuçetin, e përcuall njëhërje. Hëngri puru fukacën e qumshtit ç'i kish dërguar e jëma e asáj kriatúr e vú e fjëjti.

Më tardu ish e venej atena një búrr, kaçatúr, ç'ish vatur a kaçá. Batirti, batirti..., pá se nëng rrispëndonej, penxarti brutu e hiri mbrënda. Kur hiri mbrënda ka kamara, pá uljkun mb'truall me at bark të frítur e penxarti se mund kish ngrënë nanën. Muar thikën e i preu barkun e e vrau. Si i preu barkun uljkut, gjet Kapuçetin me nanën ç'ishën e rrijën, angora nëng kishin vdekur. Dualltin allura të dija, u bracartin nana e mbesa e ndijtin sembri kutjend. Atij kaçaturit i dhán një bikier vér.

Ata ján atjè e pín vér, na jemi këtu e pími új.

Narratore: *Giovanni Garofalo - Paese: Spezzano Albanese - Età: 66 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: contadino - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*

DHELJPRA E ULJKU

Ish një hér një uljk ndë málj çë kish ú, kish shum pitit. Xhirarnej pakund ditën sa t'gjënej gjë sa t'e hanej, pá një dheljpër. I tha:

- Ndrikulla dheljpër, ka jé vete?

- Kumpà', vjen se kam një llok çë mund ndëndemi me djáth? Ësht aq djáth tek ajo shpí...

- Vinj, vinj! Si ngë vinj! Kam aq ú! E çë hérë? - piejti uljku.

- Verso mjesnat.

- Ëh, ëh, mír, verso mjesnat.

Ish, thómi, se mjesnát ç'u nistin udh-e-udhë, u kallarëtin ka malji e arrëvuan ka voshku mbë katund te shpia e pekurarit. Më pár pan se ish e fjëjën e pstajna hitin ka vëra mbrënda. Kish atí shum djáth, kish gjíz, e të tjera cikamika. Allura u vún t'hajën...

- Hami sa domi! - tha uljku - ka aq këtu...

- Ëh, hami, hami! - tha dheljpëra.

Ma kjo ç'ish furbe, ish e venej ca t'matej te vëra, ndë se mënd t'díl. Hëngër edhe një cík e venej e matej, edhe një cík e venej e matej...

- Ç'jé bën, ndrikulla dheljpër? - piejti uljku atë.

- Faregje. Jam e shoh ndëg është njerí përjashta.

- Ruaj, ruaj! - tha ki e hanej ntantu shum djáth pse kish aq ptit e hanej edhe, hanej...

Dheljpëra pá se u kish májtur, u kish fritu e duall qetu-qetu përjashta. Si duall, u vú e thrriti mbë katund:

- Ngit, ngit! Uljku hà djathët! Uljku hà djathët!

E gjegj pekurari, u zgjua e nd'at mument, dreq arrëvoi aténa e gjet uljkun atí mbrënda me barkun të frítur ç'ish ndëndur aq shum.

- Ti çë bën këtu?

- Faregje, faregje... - tha ai.

Muar allura bastunin, një drú i madh e e bëri bote-bote, zú e rrahu mir-mir, sa i duall djathët ka grika e ka bitha...

- Pópooo... ! - thërriti ki.

Ndrikulla dheljpër kish ikur e vinej fshehur e qeshnej.

Narratore: *Giovanni Frascino - Paese: Spezzano Albanese - Età: 11 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*

QIQËRELJA

Një hér ish një búrr e një grua ç'ishin pa fare bílj. Gruaja parkaljesnej Zotin Krisht se duaj një kriatur e thonej:

- Kutëndohësja edhè t'ish një qiqërelje.

Gruaja prá pat një bílj ç'ish sa një qiqërelje. Ajo ju rrit e zú e i ndihu mbë shpít.

Një díf e jëma e vú ngaljuar te ghajdhuri e sa mos t'binej, e kllau te veshi i ghajdhurit e e dërgoi sa t'i sill bukën t'jatit ka vreshta. Udhë-e-udhë Qiqërelja thonej:

- Llargohe ni gure kaha udha, llargohe ni gure kaha udha se shkon Qiqërelja!

Gjindjat llargoheshin e thojën:

- Ki ghajdhúr ka fatzën ngráh?

Prá Qiqërelja arrëvoi tek i jati ka vreshta e i ljëreu bukën. Prá u kallar e vate u vú mbálj një dhematje. Nanì ghajdhuri hëngër dhematën me Qiqëreljen. Kur ish të mbjidhej i jati, véj tue kërkuar e thrrit:

- Qiqëré, Qiqëré! Ku jé?

E Qiqërelja ju përgjegj:

- Jam te barku i ghajdhurit. Jam te barku i ghajdhurit. I jati vrau ghajdhurin, i hapu barkun e nxuar Qiqëreljën.

Njetër díf Qiqërelja vate papán t'i qellnej bukën t'jatit ka vreshta. Udhvet gjégj thën se i biri i rregjit ish e vdis e jatronjët ngë kishin ç't'i bëjën më. Qiqërelja nëng vate tek i jati ka vreshta e vate te pullasi i rregjit. Hiri mbrënda e ju vërngut te kamara e prinxhëpit. Atjè pa t'jëmën çë kjanej, kjanej e i tha:

- Mos kjaj më, zónj, se të t'bír e shronj u!

Rrëxhina ju pruar e tha:

- Ku jé ti ç'fole? Kush jé?

- Jam Qiqërelja! Mirrëm se jam këtu mb'truall e vërëm sipër shtratit se kam i thom një fjálj te veshi t'it biri.

Rrëxhina e muar Qiqëreljën e e vú mbaj shtratit, e ajo i folji një fjálj te veshi prinxhëpit. Ki prinxhëpi u vú e qeshi e i shkoi gjithësè'. Prá ju ngrè ka shtrati e desh t'dinej kush e kish shëruar. E jëma i tha:

- Të shëroi Qiqërelja.

Prinxhëpi e piejti të jëmën:

- Oj më', e ku është Qiqërelja? Ku është?

Rrëxhina thërriti e tha:

- Qiqëré, ku jé? Ngít, ngít se ka të t'njoh im bír!

- Jam këtu, zónj! - rrispondoi ajo.

- E ngít, ngít këtë!

Qiqërelja allura u ndrrua e u bë një kopilje shumë e bukur. Prinxhëpi e pá kështu të bukur vajzën e desh t'e martonej. Edhë rrëxhina pat shumë haré. Te pullasi allura bën një tries ku hëngtën e pitin dhëndrri, nusja e rrëxhina e një pár qind veta... e u, sa lajta vét taljurët e pita ljatirën...

Ata ján atjè e na jemi këtë.

Narratrice: *Beatrice Fasanelli - Paese: Spezzano Albanese - Età: 53 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: madre albanese - Professione: casalinga - Data della registrazione: 15. X. 1967.*

FJALJË T'URTA

Kush nëng ká shpí, nëng ká gjitoní.
Di më mír çoti te shpia e tij, se i urti te shpia e jetrit.
Dirq e ljëtí, mos i qas mbë shpí.
Si është dhia, vjen kaciqi.
Me një fik, bën një mik.
Kush nëng gjëgjën t'jëmën, gjëgjën njerkën.

Narratore: *Giovanni Garofalo - Paese: Spezzano Albanese - Età: 66 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: contadino - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*



Facciata del Santuario di S. Maria delle Grazie

FJALJË T'URTA

Më mír një vé sot, se një púlj mot.
Kau i thót kornút ghajdhurit.
Një ç'bën keq, gjën keq.
Ec edhè shtrëmbur, po folj dreq.
Ësht më afër gjitoni se gjëriu.
Më mír një vé sot se një púlj menát.

Narratore: *Nicola Libonati - Paese: Spezzano Albanese - Età: 60 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: contadino - Data della registrazione: 3. VIII. 1968.*



Interno del Santuario

SCIOGLILINGUA

Ish një hér një mëm e nj'tát
Ván e rán ka një katrát,
Katrati u skullaqár
E Mikelji u mbraqár.
Vate Pjetri me hiljnarin
e i dogji rrushanarin.

Narratore: *Giuseppe Carnevale - Paese: Spezzano Albanese - Età: 11 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*



S. Maria delle Grazie, Patrona di Spezzano Albanese

SCIOGLILINGUA

Tupi-tupi bën kashuni,
Jipi búk atij ghuanjúni.
Kam një delje pják-pják
Kur piell új i jap.

Hopi-hopi, kavallopi,
M'iktin peljat alli troti
E më van njér te Prati,
M'i ngapoi Çiçirati.

Narratore: *Giovanni Frascino - Paese: Spezzano Albanese - Età: 11 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*



S. Maria delle Grazie (1970)

PROVERBI

I gjegjet vuxha e vét ngë duket.
Vejën si maçja e qeni.
E di luga ç'ë ka poçja.
Kush kërkon gjën.
E treta, e vërteta.
Sa siell ora, ngë siell viti.
Shí e mort mos ljut.
Shtie gurin e fshehën dorën.

Narratrice: *Maria Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 17 anni - Istruzione: III magistrale - Genitori: ambedue albanesi - Professione: studentessa - Data della registrazione: 3. VIII. 1968.*

PROVERBI

Pishkut i vjen era ka koca.
E dimi ku jemi ljer, ma ngë e dimi ku do t'vdesmi.
Búrr e grua, mish e thua.
Múshk e búrr ngë rrinjen kurr.
Gruaja ka ljesh e trú fare.
Gjaku ngë bëhet új.
Gjaku ín i shprishur.
I shum si ljumi, i paku si gjaku.
Shum pulja, pak vé.

Narratore: *Raffaele Fera* - Paese: *Spezzano Albanese* - Età: *30 anni* - Istruzione: *universitaria* - Genitori: *albanesi* - Professione: *insegnante* - Data della registrazione: *2. VIII. 1968.*

SCIOGLILINGUA

(Formula di lussazione per il foruncolo)

Piçka, piçka, ku jé?
Jam prapa kucarit.
E kucari ku është?
E dogji zjarri.
E zjarri ku është?
E shuajti uji.
E uji ku është?
E pitin qét.
E qét ku ján?
Ján mbálj gjëmbit.
E gjëmbi ku është?
E hëngri dhía.
E dhía ku është?
E hëngri uljku.
E uljku ku është?
Uljku hiri mbë qísh
E çoj një grua...
E kjo grua
E rashkarti me nj'thua,
E e shtú ndë një prrua.

Narratrice: *Maria Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 17 anni - Istruzione: III magistrale - Genitori: ambedue albanesi - Professione: studentessa - Data della registrazione: 3. VIII. 1968.*

PRRALLEZA E LLINDERNËS

Nj'hër ishën një búrr e një grua ç'kishin di bílj. Njëri djálj, më i urti, vdiq. Shkoi një cík mot e vdiq edhe i jati. Një díti i diti bír duall të mirr një cík ajër. Udhë-e-udhë gjet një búrr e i tha:

- Oj lja', si vemi?

Ai ju përgjegj e i tha:

- Biri im, ti ku jé vete?

- Lja', vdiq tata e im vullá e nanì qindrova ndë mest udhës. Ti mënd më mirrnje t'shurbeja me tij?

- Mënjëhére doj t'vija t'njihja të tëm.

- Eh, ngit, ngit!

Allura ván mbrënda e trimi i tha s'jëmës:

- Oj më', erdh ljalja se do të t'njóh.

Ai burr i tha gruajes:

- Nanì it bír vjen e shurben me mua jasht katundit.

- Ëh.

Mbrëmanet hëngtin e prá ván e fjëjtin. Burri i tha gruajes:

- Nesër menát ke t'na zgjoç njëhere!

- Ëh.

Menatnet gruaja i zgjoi njëhére. Burri kur ish e ikjën, i ljeu gruajes dhjet dhukat. Gruaja i tha burrit:

- Shih, mos m'e qell te një údh e ljig djaljin!

Burri ju përgjegj:

- Mos u llav, zónj, se it bír vjen e bëhet barún.

Burri e djalji muartin një kálj për një e u nistin. Ngisjë trimi përpara e burri prapa, e trimi i thonej:

- Oj lja', kur arrëvomi?

E burri:

- Biri im, njëtër cík, njëtër cík...

Ngá njëtër cík e trimi i tha papán:

- Oj lja', kurr arrëvomi?

- Dalj-e-dálj arrëvomi, ti bír.

Tue ngár, tue ngár arrëvuan te një shesh. Atjè ish një gúr i madh. U kallartin ka kalji e ljalja tha:

- Ec te duaqit e mirr tërkuzën!

Trimi vate e e suall mb'llok. Ljalja i tha:

- Nanì ké t'ngreç kët gúr!

Djalji përvoi e ng'ë bëri t'ë ngrëhnej se ngë kish fuqí. E burri i tha:
- Ti ké t'ë ngrëç, mos të ljënj këtu e ikinj.
Trimi ju përgjegj:
- E ik...
Ljalja bëri një cóp údh e u pruar prapa e i tha:
- T'ë ngrënj u gurin.
E ai burri muar e ngrëjti gurin. Djalji ruajti e tha:
- Sa brutu është këtu!
Ljalja muar tërkuzën e i tha:
- Nanì t'ljidhinj e ti ké t'veç posht. Posht ké t'ecç gjith paru e tek e ljuritnja shpí te një stip është një llinderën. Ti mirre, zgjidhu ti e ljidh llindernën...
Kur trimi arrëvoi te shpia posht e gjet llindernën tha:
- Ëh, ëh, ma na kem vemi t'di ljart.
Burri ljart thoj:
- Jóre, jóre, vét llindernën dërgomë ljárt se prá t'marr tij...
Burri: ëh! e trimi: jore! për shum mot, prá ljalja muar gurin e mbuljoi gropën papán e iku. Trimi muar llindernën e u qas papán te stipi. Atjè gjégj një ajër i fórt e tha:
- Dimi ç'është? Nanì shtihem një cík e fjë...
Trimi llindernën e vú aprápa te gradha e i zú gjumi. Mbet një cík e dí cík e ju zgjua e u pruar. Sa trimi u pruar, llinderna tha:
- Çë do?
- Dua t'vet mbë shpít!
- Ti prit një cík!
Trimi u ngrè e mbanej llindernën fort te dora e djatht e duall përjashta. Nd'at dhé ishin tropa me ár. Ai mbjoi mëngët e kusheljt. Prá ngau, ngau papán llindernën e ajo i tha:
- Çë do?
- Njëmend kam vete mbrënda te mëma.
- Ëh.
E dréq trimi u gjënd mbë shpít. Kur e pá e jëma, i tha:
- Biri im, ku vajte gjith kët mot? Sa bën e u heljmova.
I biri i tha s'jëmës:
- Oj më', qè ljalja...
E djalji u mbullí te nj'kamar. Prá vate e jëma, batirti ma i biri ng'i rrispëndoi. Shkoi një cík e trimi thrritti t'jëmën e i tha:
- Oj më', shì se u dua t'biljën e rregjit. Ti ké t'veç t'ja thuaç rregjit.
E jëma i rrispondoi:

- Biri im, ngë mund jét!
- Ti ké t'veç, oj më', e ké t'i sillç kët çist me ár!
- E mund vete kështu si jam?
- Ti nisu, se prá kur t'arrëvoç atjè te rregji, u bi t'gjëndeç një zónj e bukur si hëna.

E jëma vate te rregji t'bënej kushqín t'birít. Nanì rregji tha:

- U dua t'shoh të t'bír, zónj!

- Èh.

E jëma e trimit vate mbrënda e i tha t'birít:

- Biri im, rregji do të t'shóh. E ti si vjen atjè?

- Më', e shoh u. Ti mos u llav! Kur kem vemi?

- Kem vemi të shtún.

Të shtuntën u pripravartin e ván. Sa arrëvuan te dera e pullasit e rregjit, ish një servitúr e i thán:

- Na kem fjasmi me rregjin.

Servituri i tha:

- Sonde kin fjëni. Somenát ngë ka ngé.

Trimi ngau llindernën te kushalli e i tha:

- Bi t'gjëndemi t'di t'veshur t'mira!

È ftét, llinderna bin'e u gjëndtin t'di të stoljisur t'mira shum.

Servituri, kur i pá ashtu të stoljisur, i tha:

- Nanì mund hini! Ngini, ngini!

E trimi e e jëma u hiptin ljart te rregji. Kur rregji i pá, e jëma e trimit i tha:

- Njó, se solla tim bír!

Rregji zú e foji dréq me trimin e prá thritti t'biljën e ja buftoi. Rregji i tha së biljës:

- Ti e do për dhëndërr kët trim t'bukur?

Kopilja ju përgjegj:

- Ta', mua më pëlqen e e dua.

- Allura tek e dieljta e jetrës jáv mund martoheni.

E jëma e i biri iktin e ván mbrënda. Kur erdh e shtuna, trimi natën ngau llindernën e i tha:

- Ka t'gjëndet një pullas më i mír se ai i rregjit!

E pullasi ju gjënd dréq. Të diljtën menatën njëhére ju ngrè serva e rregjit, hapu finestrën e pá dréq at pullas më i mír se ai i rregjit. U ngudhír e vate te rregji e i tha:

- Oj zoti rrë', përpara neve është një pullas më i mír e më i madh se tëndi.

Rregji i tha:

- Mirr e ec fjëj, se ngë mund jét!

- Ngit stróte, sá t'e shohç!

- Ec fjëj!

- Ngë do t'veç, stróte, jé t'vinj rrëxhina.

Rregji, ç'edhè ish mbë shtrat, i tha:

- Prit, prit një cík, se kam shoh u!

Rregji u ngrè' ka shtrati e duall ka finestra e ruajti. Kur rregji pá at pullas aq i bukur, ju ngudhír e vate e ja tha t'shoqes. Rrexhina i tha:

- Ec shih papán se jam e vinj edhè u!

Kur rregji e rrexhina e pán, qëndruan me grikën e hapt e thán:

- Sa t'bëjëm tonin u desh aq mot, e kì u bë te një nát.

Menátnet gjindjat çë shkojën e gjith gjitonía qëndrojën me grikën e hápt tue ruajtur at pullas të bukur. rregji dërgoi karrocën me kueljt sa t'mirr dhëndrrin. Kur arrëvoi te dhëndrri, servituri tha:

- Te kjo kaljive ka t'vinj t'rrí e bilja e rregjit?

Dhëndrri partirti me karrocën e vate te nusja. Prá u nistin e ván gjith mbë qísh sa t'vejën kurór. Kur dualltin ka qisha, rregji i tha nuses e dhëndrrit:

- Qëndroni një cík! Ime bílj pa shpí e pa stoljí, ku ka t'vér'e rrí?

I dhëndrri ju përgjegj:

- Vemi këtena! Mos u llav fare!

E muartin udhën ka pullasi. Kur arrëvuan te pullasi, trimi i tha rregjit:

- Njó, ku është pullasi im e shpia s'at bílj!

Rregji, rrëxhina e gjith krishterët qëndruan me grikën e hápt e të nganduar. Prá bën triasën e dhopu ç'hëngtin, qëndroi vét dhëndrri e nusja. Dhëndrri i tha së shoqes:

- Ec fjëj!

E shoqja i tha:

- E ti, ku ké t'veç?

- Sa vete mbullinj derën.

Dhëndrri u kallár e vate híri te vatra e fjit vét: "Nanì ku kam e vë kët llinderën?". Allura e vú prapa një sënduqi. Llinderna atjè dukej. Tek e dita díti i tha s'shoqes:

- Ëm skupetën, se kam véte e vras një ljepur!

E dhëndrri u nis. Nanì ka pullasi shkoi një kaudharár e thoj:

- Kush do t'ndrronj llinderna t'rea me t'vjetra? Kush do t'ndrronj llinderna t'rea me t'vjetra?

Duall nusja e e thritti:

- Eja këtu! Ngjit, ngjit këtu!

E nusja ndrroi llindernën e vjetër me një t'ré. Sa nusja ndrroi llindernën, u buar ajo e pullasi. Kur u mbjodh i shoqi e ngë gjet më pullasin e t'shoqen, vate tek i vjehrri e i tha:

- Jot bílj m'shtú për dierr... Ëm një kálj, se kam vet'e gjënj!

- E ku?

- Ng'e dí!

E trimi muar kaljin e ngau pakund. Prá arrëvoi te një voshk. Atje ish një shpí. Trimi ngau derën e duall ka finestra një kopilje e bukur. Ajo ish e shoqja e ai sa e pá, i tha:

- Çë bëre? Çë bëre?

E shoqja i tha:

- Çë bëra? Sa ndrrova at' llindernën, ng'u gjënd më pullasi e u...

- E nanì si kem bëmi?

- Një mumend, se nanì maghu është e fjë. Ti ke t'veç te deti. Atjè ján tre pullumba: një i zí, një i bárdh e një te kulluri i hiut. Ti ké t'marrç atë te kulluri i hiut. Vrite te deti e mirri vén ç'ká mbrënda te barku. Prá sille këtu, se kur maghu është e fjë, i zbatirën vén ndë ballët e ai t'thót ku është qiçi sa t'marrç llindernën...

- E trimi ngau e kështu bëri. Prá sa i zbatirti vén nd'kriet, maghu ki' i tha ku ish qiçi. Trimi e muar qiçin e vate muar te sënduqi llindernën. Prá zgjidhi t'shoqen, ç'ish ljidhur me nj'tërkuz e ju pruartin papán te sheshi ku ish pullasi. Tek ai shesh ngau llindernën e i ljipu papán një pullas më t'mír se ai i pari. Llinderna ja bëri e trimi me t'shoqen rroi atjè mbrënda për një milj vjet të bukura.

Narratore: *Emilio Amato - Paese: Spezzano Albanese - Età: 42 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: panettiere - Data della registrazione: 22. X 1967.*

DI VULLEZËRIT E BRIGENTËT

Ishin një hér di vullezëra. Një ish çót e një ish spért. Allura véj' e pashirin deljet nga menát nga menát. E jëma i tha:

- Ngini alle dieçi se ju jap bukën.

Një ka ata vate alle dieçi. Allura pá një hjé, një hjé... dinej se ish një burr, shtu bukën me gjithësè' e iku e vate u ngudhír tek i vullau e i tha:

- Ján e vijën brighentët!

Allura shkuan ka një dér ç'ish e hapur, një pórt, muartin at' pórt e u hiptin te një arvur. Allura këta u hiptin te një arvur... brighentët xhustu tek ai arvur nën ván e u vún e ish' e kundarjën dicá solldede...

Allura ki çë mbanej derën ngë mund t'rrizistirnej se kish t'bënej pí... kish t'bënej... e nuk mund t'rrizistirnej. Tha:

- Nëng mund t'rrizistirinj më!

- Ma rrizistír njetër cík! Tha:

- Ma nëng mund t'rrizistirinj më!

- E prá bëne!

E bëri. Tha ai brighanti:

- Ç'është?

- Jan e pisharnjën zogjët... - tha një nga ata.

- Ësht e bie shí... - tha njetër.

Allura tha ki vullau mbal arvurit njetër hér:

- Nëng mund t'rrizistirinj, kam kakarinj... nëng mund t'rrizistirinj më...

- E kakár! - i tha jetri vulla. Çë mund t'i bënj?

Allura ki kakárti... Një brighént përposht thoj:

- Ç'është?

E, kakarjën zogjët... - tha jetri.

Allura e treta hér tha ki atjè ljárt:

- Nëng mund mbánj më kët dér! U e shtije...!

Shtu derën... Ata brighentët thán:

- Ësht e bën terramot...!

Muartin e iktën e ljën solldet me gjithësè'... Ata di vullezërit u kallartin, muartin solldet e ván.

Dhoku ván u hiptin te një asoje, te një arvur, një móll, njeri ka ata... Kish pakund molla. Allura i tha deljevet:

- Ljirenmi një, se njëmos, kur vemi, ju vras gjithëve!

Ai i shtú gjith, gjith... e nëng i ljen nemenu një ata... Allura kur u

kallar, i vrau gjith... Arrëvoi i vullau, ç'ish edhè tek arvuri, tha:

- Çë bëre?

- Vrava gjith deljet! U vajta e shtura gjith ata molla, ata i hëngtin gjith e nëng m'ljën nemenu një...

Dhopu kishin gjith ata sollde, ata ç'i kishin márr brighentëve e ván e bjejtin deljet.

Ata ján atjè e pashirnjën deljet, na jemi këtu e rrëfiemi përralleza...

Narratore: *Giuseppe Carnevale - Paese: Spezzano Albanese - Età: 11 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*

I VDEKURI TE TAVUTI

Një hér ish një búrr, vate te një patrún se kish ruajën një tavut ç'ish te kambësandi e thërriti puru njetër shok. Allura, sa t'nguraxharshin, kishin qellur ca butilja me vér. Versu mjesnatje u fërrnua vera. Njeri ka këta i tha jetrit:

- Ec e mirr se u fërrnua! - tha.

- Ec e mirr ti, se u kam t'e shkonj kambësandin e trëmbem.

Dhopu një cík u diçidhír njëri e vate e e muar. Ki këtu ç'kish qindruar, nxuar të vdekurin ka tavuti e e ulji te shexha. E i vú ai gjàgjë te tavuti e u vú e fjëj. Dhopu dhe nj'cík, arrëvoi jetri me verën e i tha atij ç'ish te shexha, tha:

- Se qëlla verën! Pij, pij!

Ma ki nëng fjit...

- Njó verën! Pij!

Rrispëndoi ai jetri, ç'ish te tavuti, tha:

- Ndë çë nëng do ai, pi u!

Ki këtë u trëmb e desh t'iknej...

Narratore: *Cosimo Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 14 anni - Istruzione: III media - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 1. VIII. 1968.*

TRE VULLEZËRIT

Ishin një hér tre vullezëra që nëng kishin që hajën. Allura një tha:

- U vete te një allbergh e há mir-mír... eee, ju ng'e dini si bënj u...

Thán:

- Sollde ng'ké e nëng mund t'pagaç! Tha:

- Që do t'e bënj?

Allura vate vù një asoje, një krimb te koca, e vate te allberghu. Hëngër mir-mír, hëngër pást, xhellát, gjithësè'... gjithë ata që ishin atjè... Dhopu i tha kamerjerit:

- Kjo pást ë shum e mír! Qellëm papán njetër pást!

Allura tek e dita dér shtú nj'etër krimb te pasta... tha:

- Kamerjér, eja këtu! Se ruaj që te pasta...! Tha:

- Rrì qé', rrì qé! Ik, ik se nëng ké t'pagaç fare gjë! Ik, njëmos më liçencjarnjën...!

Ai i pari vate kështù. I diti, vù di asoje, di krimba te koca. Allura vate atjè, hëngër papán gjithësè: pást, xhellát, gjithësè... Tek e dita hér tha:

- Papán një pást!

- Ësht i diti që m'ljipën papána n'pást... - tha kamerjeri.

Inveçe sa t'i vënej një krimb, i vù di, i shtú di krimba...

Allura kamerjeri i tha:

- Ik, ik se...! Mos pagaaj fare gjë, se njëmos, më liçencjarnjën...

E iku pure i diti. I treti mbjoi gjith shapkën me krimba. Vate atjè e ki këtu hëngër, piti gjithësè... Ljipu papána pást, tha:

- Pást!

Ja bën e ja qelltin papán. Shtú gjith ata krimba ka shapka... Ma kamerjeri e spijarti e e pá se kish shtún gjith ata krimba ka shapka e allura bin e e vún ngalléra ktë...

Narratore: *Giuseppe Carnevale - Paese: Spezzano Albanese - Età: 11 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*

ULJKU E DHELJPËRA

Ish një hér një uljk ç'ish e shkonej udh-e-udhë me një gjelj ngráh. Te një bív përpoq një dheljpër. I tha ajo:

- Rrì mír, kumba'! Ka je vjen?

- Qeva nd'katund e bjejta një gjelj...

- Uuu, sa bellu!

Udh-e-udhë arrivuan nguqa nj'puc.

- Rripozaremi një cík, kumba'! - i tha dheljpëra.

E vu vún e rripozartin. Dheljpëra vasharnej kocën e pá mbrënda pucit ç'ish hënëza e pjót. Mbjatu tha:

- Kumba', eja e shih! Eja e shih ç'djathët shum i madh ç'është këtjè nën... Kallaremi?

- Si bëmi sa t'kallaremi?

- Pënxarinj u! - tha dheljpëra.

E u vú te një kate, ka jetra u vú uljku ç'ish më i rënd e qè pósht ndutu nën te puci...

Dheljpëra allura, pá se ish uljku pósht, muar gjeljin e njëhérje iku. Si ish e iknej, i thërriti uljku, i tha:

- Kumba', ti hà djathët se u há gjeljin!

Narratore: *Giovanni Frascino - Paese: Spezzano Albanese - Età: 10 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*

SINJOR ROSI

Një hér ish një búrr ç'i thojn Sinjor Rosi e mbrijakarej sembri. Një dít allura inkuntrarti njetër búrr ka një vinélje e i tha:

- Mund t'më thuaç, për pjaçir, ku rrè Sinjor Rosi?

Ai tha, tha:

- Ma Sinjor Rosi nëng jé ti?

Rrëspëndoi ki këtjè e tha:

- Aposto, dua të di ku gjëndem...

Narratore: *Giovanni Frascino* - Paese: *Spezzano Albanese* - Età: *10 anni* - Istruzione: *V elementare* - Genitori: *ambidue albanesi* - Professione: *alunno* - Data della registrazione: *6. VIII. 1968.*

DI SHÓK

Një hér ishin di búrra, di shók e nëng kishin ç'kish hajën. Allura te një dér ç'ishin petkra, pán një xhakét karabinieri... Ván e kalluan. Një ka ata u vish e jetri vate e hëngër gjithësè' gjithësè'... Ai miku ish te dera e spasjonej se i bënej ghuardjen. E allura nëng kish sa t'paguanëj, thonej:

- U nëng kam sollde!

- Nanì thrres ghuardjen e bin t'vën n'gallera...

- Bine t'vën n'gallera!

Tramendka ka ish ai ghuanjún... ki ish, ish ki këtù ghuardja, ish miku, e nëng e vù n'gallera. E qelli atì te një spikún e dhopu u vish jetri, ç'ish mbrijak, ç'kish pitur gjithësè' e vate ai se i bënej ghuardjen...

Ki këtù hëngri e pìti gjithësè' gjithësè'. I tha:

- Ké t'pagaç, nanì!

- Nëng kam sollde!

- Nanì thrres ghuardjen e bin e t'vën ngallera!

Tramendka shkoi një ghuardje di veru, ai miku ç'ish mbriják... Tha:

- Ngìt se ki këtù nëng do t'paguanj:

E e vún di veru ngallera.

Narratore: *Giuseppe Carnevale - Paese: Spezzano Albanese - Età: 11 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*

NJË BURR E GHAJDHURËT

Një hér një patrún vate te markati e bjejtë pes ghajdhúr. Kur ish e prirej ka shpia, u hip ngaljuar tek një ka ata. Kur ish e ngit, u pruar e tha te koca e tij, tha:

- Si? U bjejta pës e nanì ján katër? E jetri ku ë?

U fërmár, i nimroi njëtër hér, ma ghajdhurët ishin sembri katër. Ruajti ka nj'án e ka nj'etër, fishkarti, i nimroi papána, ma ng'ish fare gjë sa t'bënej. Dhopu shkoi një burrariq e i tha:

- Pse jé kështu i rraxhuar? Çë të bën?

Patruni i tha:

- Jam i rraxhuar pse bora ghajdhurin... Mos e pe? Mos u fërmár këtë nën?

Rrispëndoi jetri, tha:

- Jóre! Tha:

- Kush mund t'e kish kalluar nën të sít?

- Ma u ng'e dí!

- Ma u kisha pës e nanì ján katër...

- Ng'e di!

Arrëvoi mbrënda. E shoqja, ç'ish e prit te dera, i tha:

- Pse jé kështu i rraxhuar? Çë të bën?

- O shoqja ime...!

- Thuajme, thuajme! - tha e shoqja.

- Eh, sot markati vate ljíg...

- E pse? Pse vate ljíg?

- Pse kisha bjejtur pes ghajdhúr e nanì kam katër... Njërin e bora, e kalluan...

- Ma kish vdisje! E ghajdhurin ç'jé sipër ngaljuar ng'e rrimënon?

Narratore: *Cosimo Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 14 anni - Istruzione: III media - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 1. VIII. 1968.*

PJERINI E FISKJATA

Një dít Pjerini ish te skolla e kish venej sembri te ghabineti. Thonej:

- Kam vete te ghabineti!

Mastra i tha:

- Kur ke t' veç atjè, ké t' thuaç: "Dua t' bënj një fishkát".

Vate mbrënda e i tha nanës, i tha:

- Na', kam bënj një fishkát! I tha:

- Jo, nanì!

- Ma kam bënj një fishkát! Nëng mund t' rrisistirinj!

- Ec e bëje allura te veshi i t' it eti! Ai tha:

- Ma një fishkát!

- Ec, ec e bëje te veshi t' it eti!

- Ma një fishkát!

- Ma ec e bëjë!

Vate allura tek i jati e i bëri pishë mbrënda te veshi...

Narratore: *Giuseppe De Marco - Paese: Spezzano Albanese - Età: 11 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*

MALLUFATU E MALLUPAGATURI

Një hér ish një fëmiljë me gjasht biljë, allura vinej karnivalli e i jati nëng kish të ngrën, allura u nis. I tha së shoqes:

- Shih se u jam e vete nd'Horët. Kam vete e shoh t'gjënj një cík fëtigh.

Allura arrëvoi nd'Horët e spasponej përpara kumendit. E pá Padre Ghuardjanin, tha:

- Pajzá, ç'vete tue gjetur? Tha:

- Doja një cík fëtigh!

- Ngà, ngà këtu, se na rrëmon jardinin!

Sikè vate atjë e bëri kuiniçi dit. Dhopu se ç'i bëri, i tha:

- E rú, dój të t'pieja si te thón? Si te thón? Tha:

- Me thón Mallufatu...

E po shkon jetrën dí, tha:

- Zotrote më piejte mua "si të thón?" - tha - U kam pienj zotrote "Si te thon?"

- Ëëë, - tha - sa vete tue gjetur...

E ai papán ja prúr, tha:

- Ma si te thón? Nëng mënd m'e thuajç? Tha:

- Më thón Mallupagaturu...

E u kuqar: Mallufát e Mallupaghatúr... Allura dhopu se ç'fërrnoi fëtigat vate se duaj paguajtur. Tha:

- Zo', ké të m'pagaç - tha - se fërrnova fëtigat! Tha:

- Nëng e dije se u isha Mallupagaturu, e? Nanì mund t'veç!

- E muar e iku. Vate mbë shpí e e shoqja e prit se i síll solldet. Tha:

- E nji, nëng i solle solldet? Tha:

- Gjeta kështu e kështu... Mallupagaturu, e nëng m'paguajti... Però nanì kam vete se kam gjënj. Ti pripararëm një vestit ka më të mirët - tha - se vete nd'Horët menát e dhopu bi t'shoh ndë më paguan...

Ki muar e vate, u vish si një sinjorín me mbroljat të shoqes e vate nd'Horët... e ish e spasponej. Vate mbë qísh e veshur grua e dhopu ç'kish gjegjur meshën. E dhopu mbrëmmanet kish t'mbullijën kishën e vate një këllogjër, tha:

- Ké t'ikç, se nanì kem mbullimi qishën! Tha:

- Joo, u bëra vút e kam fjë këtù sonde!

- E rú, nëng mund t'rríç! U kam vete jam thom Padre Ghuardjanit. Ndë çë mund rriç, e beni, se njëmós ke t'ikëç...

Ki muar e ja tha Padre Ghuardjanit, tha:

- Padre Ghuardja', - tha - është një zónj kështu e kështu... do të rri mbë qísh... Tha:

- Thuaji të rrí!

Ki muar e vate jást e ja tha:

- E sonde fjë këtu!

E kështu bëri. Ai, Padre Ghuardjani, kridhirti se ish grua, nëng kridhirnej se ish Mallufatu... Allura avizoi gjith këllogjërit!

- E rú - tha.

- È!?

- Ecni e fjëni gjith, se sonde - tha - ndëç t'gjegjni gjë rrëmúr, mos rrjidhni, mos je t'vinj njerí këtu!

E ván e fjëjtin. Kur ván e fjëjtin, ai Mallufati, u hip ljár, nxuar nj'takarjélj, nj'cóp drú, ngapoi Padre Ghuardjanin e e rrahu... Ata atej nëng rrjidhjën... e nëng rrjodh mosnjeri... Ai këtu ish'e e vrit me boba... Dhopu ç'e bëri mir-mír, tha:

- Mos më vrit më! Njó, ku është borsa, ec e mirr!

Allura i dha qiçin, bëni e muar borsën, e muar e iku... Iku, vate mbë shpí, suall gjith ata sollde mbë shpí, hëngtin e pitin... Bëri gjë drejt një pullas... Tha:

- Nanì kam vete bënj njetër - tha. Kam vete i shëronj bobat, nanì! (Perkè e kish konumartur mír...)

Menátnet u vesh si jatrua... vate atje e spasjonej përpara kumendit. Allura e pá një këllogjër, tha:

- Padre Ghuardja', Padre Ghuardja'! Ësht një bellu mediku, një jatrua, ç'është e shkon. Tha:

- Thërrite, thërrite!

Muar kë e e thërriti, tha:

- Zo' - tha - kështu e kështu... Padre Ghuardjanin e kemi smúr... Pse nëng vjen t'shohç t'e shëroç?

- Èh, - tha - se vinj!

Ki vate ljár, tha:

- Ru! - tha.

Ata ishin trembëdhjet këllogjër... I dha gjithve gjë të bëjën... Një e dërgoi Shën Mitër, një e dërgoi ndë San Kozëm, një e dërgoi Kozénc... sikè i shprishi gjith katund e katund... Tha:

- Mua me kënda... dua t'i bije papán...

Allura ata iktin... (I bëri gjith një rrimbishkrim çë nëng mund dí e shkruanej, ki Mallufati...) ... e iktin. Iktin, muar ki këtu papán e e bëri di lla Madona, me një bastún... Tha:

- Shjólj, mos më vrit më se t'jap sa do!

Allura muar ki papán e i dha njetër bors pjot me miljëra e iku. U mbjodhëtin ata, tha:

- Nji?

- Ish papán Mallufati! E she' çë më kumbinarti? Se më vrau ndutu!

- Aaa, Mallufati ish? Tha:

- E rú! E di çë kém t'bëmi? Nanì ngarkomi mushkat me petk e vemi ja sillmi, se njëmós - tha - ai nëng e fërrnon më...

E kështu bën. Ngarkuan tre mushka e ván e ja sualltin tre këllogjëra. Allura ki këtu, Mallufati, a di çë kumbinarti? Muar e bëri një grua kashtje, e vú me këmbet aljártaz se kocën apóshfaz te fukanja, ku bëhet zjarri... Allura ván këllogjërat atjè, bin e vún mushkat te stalja, i hipi ljárt... Ata kur pan atë grua kashtje (ata kridhirtin se ish grua ashtu, di veru) tha:

- Mallufa', ç'është kjo këtjè?

- Hë, ajo këtjè është mëma! Tha:

- E pse e vore? Tha:

- Më dhjeu te shtrati...

E këta ka paguar ish'e vdisjën... Tha:

- Ma vriç - tha, ndë vú të jëmën vjérr - tha - neve na vret ndutu!

Allura tha:

- Vi, nanì vëhemi e hami!

I suall te triesa, hëngtin e pítin. Dhopu se ç'hëngtin, tha:

- Vi, - tha - nanì xë fjëni! Sonde ormai nanì ë nát e fjëni këtu.

E muartin e bin e fjëjtin atje. Ki Mallufati vú një kusí me qull, me qúll e bin e e ziejti. Kur ata ishin e fjëjën, i kish zun gjumi mir-mír, muar një kóp me qúll e vate i mbrazi një kóp (me ndër) nguqa bithës... nga një... Allura u zgjua njëri, tha:

- Uh, fra' - tha - u dhjeva ngrah... - i tha jetrit.

- Fra', fra', puru ti u dhjeve ngrah...

Ai rrij prapa derës e i rriqarnej, Mallufati. Allura u zgjua i treti e të tre u vún e u ngrien, u ngrihen xhakarán ndë mes shpís... Ki hapën derën, me një bastun e i bie të treve... Këcien ka finestrat, iktin e ván te kumendi xhakarán...

Póshz qëndruan mushkat, gjithëse'e i muar Mallufati.

Ata ján atjè, na jemi këtù.

Narratore: *Nicola Libonati - Paese: Spezzano Albanese - Età: 60 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: contadino - Data della registrazione: 3. VIII. 1968.*

SHËN ROKU E SHËN PJETRI

Ish një hér një grua e allura ish Sandu Rroku e i kish bën një graxje Sandu Roku. Allura kjo i tha:

- Sandu Ro', sonde vjen e hà te shpía ime?

Ai, Sandu Roku, nëng rrispëndoi. Vate mjezdít (e kish gjegjur ki sakrëstani e u fsheh prapa Sandu Rrokut...), dhopu kjo grua i tha papán:

- Sandu Ro', sonde vjen e hà te shpía ime?

- Sandu rro', sonde vjen e hà te shpía ime?

I rrispëndoi sakrëstani, tha:

- Èhë!

Ajo vate mbrënda e pripararti të ngrënit e invitarti gjith katundin. E allura kjo gruaja vate e ja tha të vullaut e i vullau bëri Shën Pjetrin e ki sakrëstani u vish Sandu Rok... Vate sakrëstani, e si ish'e hajën, arrëvoi Shën Pjetri, ç'ish i vullau i kësaj grua, tha:

- Çë jé bën atì? - i tha atij.

- E...?

- Ti si mund dilje ka Parajsi se u kam qiçet?

Ai nëng rrispëndoi fare e ata u zún e pstajna iktin gjith e kështu fërnoi festa...

Narratore: *Giuseppe De Marco - Paese: Spezzano Albanese - Età: 11 anni - Istruzione: V elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*

KUMPA' SKUDHATI

Një hér u kuqar maçja me mundunin e allura xún e bën amúr. Partirtin, iktin e ván ngambanja e ngambanja ish'e bënej nát e u rrikoverartin te një shpí e vjetër ku ish një trá v angora di traversa. Atjè bën at, aj munduni, adurarti atjè...

- Ndrikulla maçje, - tha - këtu është adúr i uljqëvet e sonde vinjën e m'hán...

E allura si kém bëmi?

Maçja këceu te trava, tha:

- E di çë ké të bëç? Këcè këtu se u të rrëmbenj!

Ai bëri një salltu, bëj t'e rrëmbenj e vat'e rá... Një hér, dí hér e finalmente e rrëmbeu... E rrëmbeu e u vún të di sipër travës. Allura kur erdh nata, ç'u bë nát shum, verso mesnatet, ván uljqit... e cupartin trembëdhjet uljq. Atjè ai, delja, munduni be', i vinej t'bënj uj, tha:

- Si kam t'bënj? - i thonej maçes - E atë... kam t'bënj një cík uj...!

- E - tha - maçja - priru kuetu-kuetu e bën...

Ai bëri sa t'prirej, vate e rá pósht. Pósht ati me atë rëmúr çë bëri, uljqit frika iktin t'gjith... ma qëndroi një se çë kish gjumin më të fórt... U kallár maçja, e rrëmbeu për bishti. Ai ka paghura se i mirr bishtin, bëri fórc e i qëndroi bishti te grika e maçës e iku... Tue ikur, vate e i arrú ata tjerët. Tha.

Aee, iktin t'gjith - tha - e u trëmbët ka një máç e ka nj'mundún...!

- E rúj - i tha - ma tí t'mëngon bishti!

- E nanì ti ka t'jéc furizi i t'gjithve, servi i t'gjithve!

- Èh, va bene!

Venej nd'ár, ish moti dardhavet, pá se ish një dárdh e pjekur e tha:

- Kumba' Skudhat! (ja kishin vú "kumpa' Skudhát" se ish pa bisht) - than - eja, Kumba' Skudha', ti ngjitu e shkundi dardhat se na hami nën!

- Joo, - tha - ni ju hani, u ngë kam há fare... Ma kam ju ljidhinj t'gjith bisht me bisht tundu-tundu kurmúnit e dardhës, një mos - tha - nëng vemi mír...

- E va bene!

Ata u vún ashtù e i ljidhi gjith bisht me bisht kundrè' dardhës. I ljidhi atjè, u ngjit ljárt e xú e hëngër...

- Kumpa' Skudha', e kur i shtiè?

- E kam ndreqem, njinjì kam vet'e bije!

E papán ai bëni e hanej...

- Ma, Kumpa' Skudha', e kur i shtiè?
- E kam ndreqem, njinji kam vet'e bije!
Pjanu-pjanu, dhop' çë hëngër mir-mír ai, xú e thërriti:
- Ooo ngit patrú, se uljqit ján e t'hán t'gjith dardhat! Ngit, patrú, se
uljqit ján e t'hán t'gjith dardhat!
Ato xún e bën strep ka nj'án e ka njetër e shkultjën t'gjith bishtin...
Tha:
- E she', jemi nanì gjith ghuallu!

Narratore: *Giovanni Garofalo - Paese: Spezzano Albanese - Età: 66 anni - Istruzione: elementare - Genitori: ambedue albanesi - Professione: contadino - Data della registrazione: 6. VIII. 1968.*

KUSH NËNG SHËRBEN NËNG HA

Një hér ish një búrr, vate te qisha, ish Zoti Krisht e i tha:

- U ng'e dí ç'kam há...

E nga menát bënej kët manistier. Allura një dí sakrëstani u adunár e u fshef prapa autarit. Menát vate ki këtu e i tha:

- Zoti Krisht, ç'kam há?

Rispëndoi sakrëstani, tha:

- Ec shurbej!

Allura ki këtu tha:

- Nanì prit atì se vete mbrënda, marrë një gáč e vinj e të vras, t'jap u "ec e shurbej"!

Sakrëstani ju trëmb, muar e nxuar Krishtin i madh e vù një piçiniq... Allura ki búrr arrëvoi me gáčën e tha:

- Birari, ku vate it'át se kam e vras!

Narratore: *Cosimo Leccadito - Paese: Spezzano Albanese - Età: 14 anni - Istruzione: III media - Genitori: ambedue albanesi - Professione: alunno - Data della registrazione: 10. VIII. 1968.*

Italiano

LA VOLPE E IL CORVO

C'era una volta un corvo molto affamato.

Andava in giro per trovare qualcosa da mangiare e, girando girando per tutta la giornata, non trovò nulla. Poi vide un uccello, cioè un corvo, su di un albero, che mangiava un pezzo di formaggio. Disse:

- Uuuh, come sei bello! Peccato che non sai cantare e quindi non sei poi così bello. Lui disse:

- Se vuoi vedere come veramente sono bello, so anche cantare così: Qua, qua, qua... - e gli cadde giù il formaggio.

La volpe subito lo prese e se lo mangiò. Allora il corvo si mise a gridare perché gli aveva mangiato il formaggio, ma la volpe si allontanò dicendo:

- L'hai visto e non lo vedrai mai più!

Narratore: *Cosimo Leccadito, Spezzano Albanese. - Aa. Th.*

IL LUPO E LA PECORA

C'erano una volta un lupo e una pecora, cioè un agnello, e andarono tutti e due al fiume ad abbeverarsi. Il lupo si mise più sopra e l'agnello più sotto. Sebbene l'acqua fosse limpida, il lupo disse all'agnello:

- Giovanotto, perché m'intorbidisci l'acqua?

Rispose l'agnello:

- Come posso intorbidirti l'acqua se tu sei più sopra e io più sotto?

Il lupo aveva trovato soltanto una scusa per poter divorare l'agnello.

Allora il lupo si agitò. Disse:

- Adesso vuoi dire che ho torto?

Rincorse l'agnello, lo raggiunse e lo afferrò, gli saltò addosso e lo divorò.

Narratore: *Cosimo Leccadito, Spezzano Albanese. - Aa. - Th.*

CAPPUCETTO ROSSO

Una volta c'era una bambina che si chiamava Cappuccetto Rosso, poiché la nonna le aveva regalato un cappuccio rosso che lei portava sempre sulla testa. Un giorno la madre la chiamò per dirle:

- Senti, devi prendere questo cibo e portarlo alla nonna. Però sta' attenta, perché per la strada c'è un lupo e ti può divorare. Rispose:

- Va bene. - e partì.

Arrivò al bosco e trovò alcuni fiori rossi, gialli, e si mise a coglierli. Apparve il lupo, disse:

- Bimba, cosa fai lì?

- Ecco, sto raccogliendo alcuni fiori, che li devo portare alla nonna insieme a questo cibo.

Il lupo domandò: - Dove sta tua nonna? Perché anch'io devo andare a trovarla.

- Sta lì dietro.

Allora il lupo la salutò e subito se ne andò via per arrivare prima della nipotina, della bambina. Se ne andò, arrivò dalla nonna e bussò alla porta. Appena lei aprì, l'assalì alle spalle e la divorò. Giunse anche la bambina che portava il cibo alla nonna e bussò. Disse il lupo:

- Chi è?

- Sono la tua nipotina. Apri!

Il lupo aprì la porta ed entrò la bambina. Disse quella:

- Aaah, nonna, hai gli occhi così grandi!

- Sì, per vederti meglio.

Dopo un po' disse:

- Hai le orecchie così grandi.

- Per sentirti meglio.

Poi disse:

- Hai le unghie lunghe.

- Per afferrarti meglio.

Dopo di nuovo disse.

- Hai la bocca così grande.

- Per mangiarti meglio.

L'assalì e la divorò. Allora la madre, vedendo che non rincasava, mandò là un cacciatore. Lui arrivò e sentì un rumore dentro la pancia del lupo. Lo prese e lo portò in un bosco dove c'era l'acqua. Gli aprì la pancia e uscirono la bambina e la nonna.

Ringraziarono il cacciatore e se ne andarono. Lui prese la pelle del lupo e ritornò in paese.

Narratore: *Cosimo Leccadito, Spezzano Albanese. - Aa. - Th.*

IL FRATELLO, LA SORELLA E LA MATRIGNA

Una volta c'era un uomo che aveva due creature; la moglie era morta. Quest'uomo non poteva vivere da solo. Rimase così a lungo, ma poi si sposò con una donna (la matrigna) la quale aveva due figli. Questa ai figli di lui faceva fare molti servizi e i due figli suoi riposavano. Un giorno, mentre stavano mangiando a tavola, disse al marito:

- Tu devi prendere queste due creature e andare a lasciarle nel bosco!

Così il padre disse loro:

- Andiamo nel bosco!

Ora quei due ragazzi andarono dalla nonna e le dissero:

- Nostro padre deve portarci nel bosco, dacci qualcosa!

La nonna diede loro alcuni semi di ceci e disse:

- Voi, quando prenderete la strada, gettate uno alla volta i ceci.

Arrivarono nel bosco e il padre disse loro:

- Voi restate qui, perché io vado a raccogliere la legna e poi verrò a prendervi.

Egli se ne andò a raccogliere la legna, ma non ritornò a riprenderli. Se ne andò. Lui se ne andò e quelle due creature rimasero sole sole. Ma, avendo disseminato i ceci ritrovarono la strada e ritornarono a casa e si misero dietro la porta; ma si vergognavano di entrare, perché dentro stavano mangiando.

Il padre, poiché era rimasta un po' di pasta, disse:

- Ecco, se ora fossero qui quelle due creature, la mangerebbero...

